



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

STRATEGJIA PËR ODËN E INFERMIERËVE, MAMIVË DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDETËSORË NË KOSOVË

2025–2029

Shkurt 2025

Ky dokument është përgatitur dhe publikuar me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit Shërbime Shëndetësore të Integruara (IHS), një nismë e përbashkët me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, që zbatohet nga Instituti Zviceran për Shëndet Publik dhe Tropikal (Swiss TPH). Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së



**Integrated
Health
Services**

SDC project implemented by Swiss TPH



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Strategjia për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë

2025–2029

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat	4
Parathënie e Kryetares së OIK-ut	5
1. Hyrje	7
2. Përmbledhje ekzekutive	8
3. Masat prioritare	10
Digjitalizimi	11
4. Metodologjia	11
5. Përmbledhje e gjetjeve nga Raporti i Analizës së Situatës	12
5.1. Korniza ligjore e OIK-ut	12
5.2. Menaxhimi i Odës	12
5.3. Shërbimi administrativ dhe profesional	13
5.4. Anëtarësimi, licencimi dhe rilicencimi	14
5.5. Edukimi i vazhdueshëm profesional	15
5.6. Digjitalizimi	16
6. Analiza SWOT për OIK-un	17
7. Misioni dhe vizioni	17
7.1. Misioni i OIK-ut	17
7.2. Vizioni i OIK-ut	18
8. Objektivat strategjike	18
8.1. Korniza ligjore e OIK-ut	18
8.2. Qeverisja dhe shërbimi profesional	21
8.3. Licencimi, rilicencimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional	24
8.4. Digjitalizimi	27
8.5. Avokimi dhe bashkëpunimi	29
9. Sistemi i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit për Strategjinë Institucionale të OIK-ut	30
9.1. Objektivat e sistemit	30
9.2. Struktura e monitorimit dhe raportimit	30
9.3. Rolet dhe përgjegjësitë për monitorimin dhe raportimin	30
9.4. Shpeshtësia e raportimit	31
9.5. Vlerësimi i Strategjisë	31

Strategjia për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë 2025–2029

Ky dokument është hartuar me mbështetjen e projektit IHS. Përmbajtja e tij është rezultat i grupit punues të OIK–ut si dhe ekspertizës së ofruar nga eksperti i jashtëm i angazhuar nga Projekti, dr. Ruzhdi Halili.

Kontribues: Grupi punues për zhvillimin e Strategjisë për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë 2025–2029, i kryesuar nga kryetarja e OIK–ut, znj. Nexhmije Gori, dhe i përbërë nga nënkryetarët e OIK–ut, Këshilli Drejtues dhe kryetari i tij, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesit e Organeve të Odës dhe Shërbimi Profesional si dhe ekipi i projektit IHS.

Autor: *dr. Ruzhdi Halili*

Shkurtesat

KEVP	Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional
OIK	Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë
EVP	Edukimi i Vazhdueshëm Profesional
BE	Bashkimi Evropian
IHS	Shërbimet Shëndetësore të Integruara
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
AKA	Agjencia Kosovare e Akreditimit
SWOT	Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Parathënie e Kryetares së OIK–ut



Nexhmije Gori

Kryetare e Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK)

Jam shumë e lumtur që kam mundësi të paraqes para jush këtë strategji të rëndësishme për avokimin dhe Planin e Veprimit, të hartuar me ndihmën e projektit “Shërbime Shëndetësore të Integruara” (ang. Integrated Health Services) (IHS), që mbetet njëri nga partnerët shumë të çmuar të Odës së Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë (OIK).

Kjo Strategji si dhe Plani i Veprimit kanë për qëllim fuqizimin dhe angazhimin OIK–ut në mbrojtjen e interesave profesionale të anëtarëve të tij si dhe në përmirësimin e mundësive për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Strategjia dhe Plani i Veprimit do të shërbejnë si një udhërrëfyes për zhvillimin e aktiviteteve dhe nismave që synojnë rritjen e ndikimit të OIK–ut në proceset vendimmarrëse dhe promovimin e përfshirjes aktive të profesionistëve shëndetësorë në politikat shëndetësore.

Për t'i arritur këto qëllime, Strategjia dhe Plani i Veprimit fokusohen në tri objektiva kryesore:

- 1. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve në OIK–ut** – Pjesë kyçe e Strategjisë është rritja e kapaciteteve brenda OIK–ut, për të mundësuar një organizatë më të fuqishme për realizimin e misionit të saj. Kjo përfshin trajnime të vazhdueshme për anëtarët, zhvillimin e aftësive menaxheriale dhe rritjen e mundësive për përfshirje të anëtarëve në proceset vendimmarrëse.
- 2. Përmirësimi i kornizës ligjore** – Një nga prioritetet kryesore është të ndikojmë në përmirësimin dhe modernizimin e kornizës ligjore që rregullon profesionet shëndetësore. Kjo do të mundësojë krijimin e kushteve më të mira për profesionistët dhe një mbrojtje të fortë ligjore për të drejtat e tyre.
- 3. Ngritja e kapaciteteve në fushën e komunikimit, duke përfshirë informimin dhe edukimin publik për rolin e OIK–ut** – Një aspekt thelbësor i Strategjisë është rritja e ndërgjegjësisë dhe edukimit publik për rëndësinë e profesionistëve shëndetësorë në shoqëri. Përmes fushatave informative dhe edukative, synojmë të rrisim vlerësimin për rolin e infermiereve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, duke kontribuar kështu në një sistem shëndetësor më të qëndrueshëm.

Strategjia që po paraqesim bashkë me Planin e Veprimit janë rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë me ekspertë dhe organizata me kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e shëndetësisë dhe avokimit, të cilët kanë kontribuar me njohuri dhe përvojë për të krijuar një plan veprimi të qartë dhe të qëndrueshëm.

Ky plan është orientuar nga nevoja për t'i përforcuar kapacitetet tona të avokimit dhe për të ndihmuar në adresimin e çështjeve kyçe që prekin profesionistët dhe shërbimet shëndetësore në përgjithësi.

Besojmë se ky dokument do të shërbejë si një burim frymëzimi dhe udhëzimi për të gjithë ata që janë të angazhuar në këtë mision të rëndësishëm dhe do të kontribuojë në forcimin e rolit të infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë.

1. Hyrje

Menaxhimi i profesionistëve shëndetësorë, sikurse menaxhimi i sistemit shëndetësor në tërësi, është një çështje shumë komplekse. Shumë nga përgjegjësitë që kanë të bëjnë me profesionistët shëndetësorë në Kosovë janë bartur tek Odat e Profesionistëve Shëndetësorë si institucione me status publik por me autonomi vetërregulluese për profilet profesionale shëndetësore për të cilat atyre u është dhënë autoritet me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor (nr. 04/L-150). Në kuadër të kësaj kornize, Oda e Infermierëve, Mamivë dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës (më tutje: OIK), si organizata më e madhe e profesionistëve shëndetësorë në Kosovë, është themeluar në vitin 2013 me miratimin e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor. OIK-u është bërë funksional nga data 23.01.2015 në kuvendin tij të parë. Nga data 31.06.2016 ka filluar bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë ndërsa bartja e plotë e të gjitha përgjegjësisë nga kjo ministri është bërë më datë 18.01.2018. Oda funksionon si një organ i pavarur, vetërregullues për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor, duke funksionuar brenda kornizës më të gjerë të reformave të kujdesit shëndetësor për të rritur përgjegjshmërinë profesionale dhe për të siguruar standarde të larta të kujdesit.

Mandati i Odës mbulon regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësorë si infermierët, mamitë dhe më shumë se 60 profile të tjera shëndetësore, zbatimin e standardeve etike dhe promovimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Korniza e saj ligjore është vendosur në aktet kryesore legjislative, duke përfshirë Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe Statutin e Odës, të miratuar nga Kuvendi i saj. Kjo bazë ligjore përforcohet më tej nga legjislacioni dytësor, si Kodi i Etikës dhe rregulloret që rregullojnë anëtarësimin, licencimin dhe funksionimin e organeve disiplinore të Odës.

Si një institucion i ri, Oda ka arritur progres substancial, duke krijuar me sukses kornizën e saj institucionale dhe legjislative për ofrimin e shërbimeve si për anëtarët e saj ashtu edhe për komunitetin e gjerë. Megjithatë, kompleksiteti i sektorit të kujdesit shëndetësor dhe mjedisi në të cilin operon Oda kanë sjellë sfida të ndryshme. Si rezultat, nevojiten përpertime të mëtejshme për t'i kapërcyer këto pengesa dhe për t'iu përshtatur dinamikave të jashtme dhe të brendshme në zhvillim të sektorit të kujdesit shëndetësor dhe trendeve të reja.

Prandaj, avancimi i më tutjeshëm me synim përqafimin e zhvillimeve të reja dhe adresimin e sfidave ekzistuese dhe të reja me të cilat ballafaqohet Oda dhe anëtarët e saj kërkojnë një qasje planifikuese dhe strategjike, e cila synohet të vendoset përmes kësaj Strategjie për periudhën e ardhshme 5-vjeçare. Sipas nevojës, kjo Strategji synon t'i adresojë nevojat e identifikuar për forcimin e mëtejshëm ligjor dhe institucional, qeverisjen e mirë, modernizimin dhe avancimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të brendshme.

Strategjia e OIK–ut synon të fokusohet në fushat e mëposhtme: 1. Korniza legjislative e OIK–ut; 2. Qeverisja e OIK–ut; 3. Anëtarësimi, licencimi dhe edukimi i vazhdueshëm; 4. Avokimi dhe komunikimi; dhe 5. Digjitalizimi. Ndërsa kjo strategji dhe plani i zbatimit të saj përbëhen nga mekanizmat e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të parashikuar në pjesët përkatëse të Strategjisë, fusha e avokimit dhe komunikimit do të zbatohet nëpërmjet një dokumenti tjetër strategjik dhe komponentëve të tij zbatues. Megjithatë, objektivat kryesore për fushën e avokimit dhe komunikimit të jashtëm përcaktohen nga kjo Strategji.

Edhe pse Strategjia ofron një kornizë substanciale të planifikimit, suksesi dhe ndikimi i kësaj Strategjie në punën e Odës varet në masë të madhe nga vullneti dhe përkushtimi aktiv i menaxhmentit të Odës. Ky përkushtim ka qenë vazhdimisht evident nëpërmjet artikullimit të qartë të vizionit të përfshirë në Strategji dhe përkushtimit për zbatimin e veprimeve të nevojshme për ta arritur atë. Po aq të rëndësishëm në realizimin e vizionit të Strategjisë janë edhe angazhimi, mbështetja dhe përkushtimi i të gjithë stafit të Odës, i cili luan një rol qendror në zbatimin e saj.

2. Përmbledhje ekzekutive

Strategjia institucionale e OIK–ut përfshin objektiva, tregues dhe synime strategjike dhe specifike në nivel të secilit objektiv specifik, të cilët shërbejnë si instrumente planifikimi, matjeje, monitorimi dhe vlerësimi të Strategjisë. Strategjia do të zbatohet përmes një Plani Veprimi gjithashtu pesëvjeçar, i cili është pjesë e Strategjisë.

Strategjia përbëhet nga hyrja, përmbledhja ekzekutive, metodologjia e punës për hartimin e saj, një pasqyrë e situatës aktuale që rrjedh nga Raporti i Analizës së Situatës, si dhe një analizë SWOT. Pjesa kryesore e Strategjisë përfshin kapitullin mbi objektivat për pesë fushat kryesore, të strukturuar si më poshtë:

Objektivi strategjik 1. Kornizë legjislative e avancuar dhe gjithëpërfshirëse për OIK–un, duke siguruar që zhvillimi legjislativ të bazohet në analiza, vendimmarrje të bazuar në politika dhe konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit për t'i përmbushur nevojat e Odës dhe anëtarëve të saj.

- Objektivi specifik 1.1. Rishikimi, plotësimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore me Statutin dhe kornizën tjetër përkatëse ligjore, duke thjeshtuar dhe kodifikuar dispozitat përkatëse për të reduktuar kompleksitetin, për t'i minimizuar mospërputhjet dhe për të rritur qartësinë dhe lehtësuar qasjen.
- Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi i politikave si bazë për të gjitha proceset e hartimit dhe rishikimit legjislativ.
- Objektivi specifik 1.3. Avancimi i përfshirjes dhe konsultimit të palëve të interesit në hartimin e legjislacionit të OIK–ut.
- Objektivi specifik 1.4. Avancimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e legjislacionit të Odës dhe përmirësimi i mjeteve për informimin, drejtimin dhe lehtësimin e zbatimit të legjislacionit për organet e Odës dhe anëtarët e saj.

Treguesit:

1. Përqindja e akteve të Odës që janë të harmonizuara me Statutin dhe kornizën përkatëse ligjore.
2. Numri i dokumenteve të politikave të hartuara për të shërbyer si bazë për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit.
3. Përqindja e dokumenteve të konsultuara për të cilat publikohen raportet e konsultimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të procesit të konsultimit.
4. Numri i raporteve të monitorimit të hartuara çdo vit për zbatimin e akteve legjislative.

Objektivi strategjik 2. Sigurimi i qeverisjes efektive, efikase, transparente dhe llogaridhënëse dhe shërbimi profesional administrativ i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë

- Objektivi specifik 2.1. Avancimi i sistemit të planifikimit afatmesëm të Odës, duke përfshirë planifikimin afatmesëm të punës, atë financiar dhe buxhetor, për t'i harmonizuar më mirë burimet me prioritetet strategjike.
- Objektivi specifik 2.2. Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar që dokumentet kyçe si aktet legjislative, planet e punës, planet financiare dhe raportet e auditimit të jenë lehtësisht të qasshme në faqen e internetit të OIK–ut, duke aplikuar gjithashtu rregullisht mekanizma për të marrë komente kthyese (feedback) nga anëtarët dhe palët e tjera të interesit që përfitojnë nga shërbimet e profesionistëve shëndetësorë.
- Objektivi specifik 2.3. Avancimi i strukturës së brendshme dhe proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Odës.
- Objektivi specifik 2.4. Avancimi i edukimit profesional duke zbatuar programe trajnimi për shërbimet profesionale dhe stafin menaxherial për t'i përmbushur nevojat në zhvillim të Odës dhe anëtarëve të saj.

Treguesit:

1. Të gjitha rregulloret, planet, raportet dhe informacionet tjera relevante të Odës publikohen në faqen e internetit të institucionit.
2. Niveli i kënaqshmërisë së anëtarëve me punën e Odës.
3. Niveli i kënaqshmërisë së pacientëve me punën e anëtarëve të Odës.

Objektivi strategjik 3. Avancimi i proceseve të licencimit dhe rilicencimit për të siguruar që anëtarët janë licencuar dhe përmbushin standardet më të larta të kompetencës dhe etikës, duke siguruar gjithashtu zbatimin cilësor dhe efektiv të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë.

- Objektivi specifik 3.1. Forcimi i koordinimit ndërmjet Odës dhe institucioneve të tjera përkatëse për të siguruar zbatimin e legjislacionit për licencim dhe rilicencim si dhe krijimin e një mekanizmi që adreson harmonizimin e profileve shëndetësore.
- Objektivi specifik 3.2. Sigurimi i zhvillimit cilësor të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës bazuar në nevojat e tyre afatmesme.
- Objektivi specifik 3.3. Sigurimi i monitorimit cilësor dhe efektiv dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës.

Treguesit:

1. Përqindja e profesionistëve shëndetësorë që janë të licencuar në krahasim me numrin e atyre që janë anëtarë të Odës.
2. Shkalla e mbulimit të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas nevojave të të gjitha profileve profesionale të kujdesit shëndetësor.
3. Numri i kërkesave për anëtarësim dhe licencim në Odë që refuzohen për shkak se profilet e tyre nuk janë në listën zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

Objektivi strategjik 4. Avancimi i platformës digjitale për të përmirësuar komunikimin, ofrimin e shërbimeve, proceset e brendshme, angazhimin në politikëbërje dhe aftësitë e zhvillimit profesional të Odës, duke siguruar ndërveprim efikas me anëtarët, palët e interesit dhe sistemet kombëtare.

- Objektivi specifik 4.1: Përmirësimi i faqes së internetit të Odës, pasurimi i saj me burime shtesë dhe integrimi i platformës me platformat tjera relevante kombëtare dhe të Odës (si e-Kosova, platforma e Administratës Tatimore) për avancimin e proceseve të brendshme dhe qasjen në informacion.
- Objektivi specifik 4.2: Forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe informatave kthyesë (feedback) në faqen e internetit të Odës, si p.sh. anketat elektronike dhe sistemi i parashtrimit të ankesave, duke mundësuar ndërveprim në kohë reale, mbledhjen e komenteve dhe mbikëqyrjen etike për të angazhuar më mirë anëtarët dhe palët e interesit.
- Objektivi specifik 4.3: Sigurimi i më shumë materialeve edukative digjitale dhe ofrimi i mbështetjes për anëtarët për përdorim efektiv të platformës digjitale, duke siguruar edukim profesional gjithëpërfshirës dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet elektronike.

Treguesit:

1. Numri i përdoruesve që vizitojnë faqen e internetit brenda një periudhe të caktuar.
2. Niveli i kënaqshmërisë së përdoruesve të faqes së internetit të Odës.

Objektivi strategjik 5. Avancimi i pozitës së Odës në ndikimin e proceseve legjislative dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor për qytetarët.

- Objektivi specifik 5.1: Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe aftësive të anëtarëve të OIK–ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe avancimin e rolit dhe pozitës së tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.

- Objektivi specifik 5.2: Dhënia e kontributit në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që ndikon në interesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, përmes rritjes së ndikimit në proceset vendimmarrëse dhe të formësimit të politikave.
- Objektivi specifik 5.3: Rritja e informimit dhe edukimit të publikut mbi rolin vendimtar të profesionistëve shëndetësorë dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Një kapitull i veçantë i strategjisë përcakton sistemin e saj të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit. Sistemi i monitorimit, siç përshkruhet më poshtë, përbëhet nga mekanizmat e monitorimit institucional dhe nga proceset e raportimit dhe vlerësimit.

3. Masat prioritare

Korniza legjislative

- Rishikimi i rregulloreve të OIK–ut për t'u harmonizuar me Statutin e ri të OIK–ut dhe adresimi i mangësive dhe sfidave të identifikuara.
- Aktivizimi i bashkëpunimit me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore në përkufizimin e listës së shërbimeve dhe listës së çmimeve për shërbimet e infermierisë dhe shërbime të tjera përkatëse të profesionistëve shëndetësorë. Bashkëpunimi synon të rezultojë në ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2024 – Bashkëpagesat për Shërbimet Shëndetësore, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Avancimi i sistemit të konsultimit publik për aktet e zhvilluara nga Oda, duke siguruar përfshirjen e hershme të palëve të interesit në procesin e hartimit të legjislacionit dhe përmirësimin e funksioneve të konsultimit publik në faqen e internetit të OIK–ut.
- Realizimi i aktiviteteve me anëtarët e saj pas miratimit të çfarëdo rregulloreje për të informuar, udhëzuar dhe lehtësuar zbatimin e legjislacionit.

Qeverisja dhe shërbimi profesional:

- Prezantimi i kornizës së planifikimit afatmesëm buxhetor.
- Publikimi i të gjitha dokumenteve legjislative, planeve dhe materialeve të tjera në faqen e internetit të Odës.
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për themelimin e komisioneve të Odës.
- Realizimi i anketës për kënaqshmërinë e anëtarëve në lidhje me punën e Odës si dhe anketës për kënaqshmërinë e qytetarëve/pacientëve në lidhje me punën e anëtarëve të Odës.
- Rishikimi i Rregullores për Shërbimin Profesional dhe Administrativ dhe rritja e përpjekjeve për kryerjen e trajnimeve për stafin administrativ, shërbimin profesional dhe stafin menaxherial bazuar në vlerësimet e nevojave dhe planifikimin e duhur.

Licencimi, rilicencimi dhe edukimi i vazhdueshëm profesional

- Mirëmbajtja (pastrimi) e listave dhe gjenerimi i të dhënave të sakta për anëtarët e saj dhe listat e anëtarëve të licencuar. Është gjithashtu e rëndësishme të bëhet dallimi i qartë midis atyre që kanë vetëm anëtarësim dhe atyre që kanë edhe licenca.
- Avokimi për krijimin e një mekanizmi që përfshin MASHTI–n, Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Ministrinë e Shëndetësisë dhe odat profesionale të shëndetësisë për t'i adresuar çështjet që kanë të bëjnë me harmonizimin e profileve që njihen përmes nostrifikimit, por nuk kanë profile të përputhshme në ligjin e shëndetësisë së Kosovës, për të parandaluar refuzimet e panevojshme të aplikimeve për licencim dhe njohjen dhe ekuivalencën e profileve të marra jashtë vendit dhe profileve të akredituara nga agjenci të jashtme që nuk janë të njohura nga Ministria e Shëndetësisë.
- Fuqizimi i mbikëqyrjes së cilësisë së procesit të licencimit dhe rilicencimit për shkak të volumit të madh të aplikimeve të përpunuara çdo vit.

- Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse dhe të rregullta të nevojave për trajnim për programet e edukimit të vazhdueshëm profesional për të siguruar që janë identifikuar nevojat për zhvillim profesional të të gjitha profileve.
- Përmirësimi i monitorimit dhe zhvillimi i planeve monitoruese për zbatimin e edukimit të vazhdueshëm profesional në çdo rajon.

Digjitalizimi

- Modernizimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të Odës duke e pasuruar atë me komponentë dhe funksionalitete shtesë si zhvillimi i mekanizmave të informatave kthyes (feedback) brenda faqes së internetit të Odës për të lehtësuar anketat, krijimi i një seksioni për ankesa ose kërkesa në uebfaqe.
- Ndërtimi i qendrës së brendshme për ruajtjen e të dhënave dhe arkivit digjital dhe digjitalizimi i të gjitha proceseve të arkivit.
- Zgjerimi i komponentëve të platformës për të gjeneruar statistika dhe raporte për anëtarët, profesionistët e licencuar, programet e akreditimit, etj.
- Krijimi i një biblioteke elektronike brenda platformës së Odës, organizimi i webinarëve të rregullta dhe seminareve trajnuese me anëtarët për t'i familjarizuar ata me veçoritë e reja, përditësimet dhe praktikat më të mira në mjetet digjitale.
- Avokimi për integrimin e digjitalizimit në kurrikulat e programeve të akredituara që mbulojnë infermierët, mamitë dhe profesione të tjera.

4. Metodologjia

Strategjia institucionale për OIK-un 2025–2029 bazohet në analizën e hollësishme të situatës aktuale në Odë, e cila është kryer gjatë shtatorit dhe fillimit të tetorit 2024. Gjatë vlerësimit janë shqyrtuar informacione nga burime të ndryshme, duke përfshirë legjislacionin parësor dhe atë dytësor, Planin e Punës 2024, Raportin Vjetor 2023, dokumentet e brendshme dhe një raport vlerësues institucional nga ekspertë të jashtëm nga projekti IHS. Janë mbajtur takime me palët kryesore të interesit, duke përfshirë Kryetaren e OIK-ut, Zëvendëskryetarët, Ministrinë e Shëndetësisë dhe të tjerë. Si pjesë e metodologjisë së paracaktuar, është mbajtur një punëtori në datat 27 dhe 28 shtator 2024, ku janë përfshirë shumica e organeve të Odës dhe përfaqësuesve të projektit IHS. Gjetjet e vërtetuara në punëtori kanë ofruar të dhëna shtesë dhe ishin bazë për finalizimin e drejtimeve strategjike, objektivave, misionin dhe vizionin për strategjinë institucionale të Odës.

Drafti i Strategjisë së OIK-ut, i zhvilluar fillimisht nga eksperti i angazhuar për këtë qëllim, i është dorëzuar për komente ekipit të projektit IHS. Në bazë të komenteve dhe rekomandimeve të pranuar, është hartuar gjithashtu edhe versioni fillestar i Planit për Zbatimin e Strategjisë. Drafti i Planit të Zbatimit ishte ndarë me organet drejtuese të Odës në nëntor dhe shërbeu si material përgatitor për të lehtësuar finalizimin e tij në punëtorinë e dytë të planifikuar për në dhjetor. Punëtorja e dytë, ku ishte diskutuar dhe ishte arritur pajtimi për aktivitetet dhe treguesit e Strategjisë, u mbajt më 6 dhjetor 2024. Në këtë punëtori, të kryesuar nga Kryetarja e Odës, morën pjesë përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, Zëvendëskryetarët e Odës, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, stafi nga shërbimi profesional i Odës, si dhe ekspertë nga Oda dhe projekti IHS.

Punëtorja e 6 dhjetorit rezultoi në draftin e Planit Zbatues për Strategjinë e OIK-ut 2025–2029, i cili u nda me ekipin e projektit IHS dhe organet drejtuese të Odës gjatë dhjetorit të vitit 2024. Për më tepër, diskutimet dhe rezultatet e reja nga punëtorja, takimet me ekipin e projektit IHS dhe informacione të tjera u pasqyruan në versionin përfundimtar të draft Strategjisë, e cila u procedua më tej në dhjetor së bashku me Planin për Zbatim të saj.

Strategjia për Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë në Kosovë 2025–2029 dhe Plani për Zbatimin e saj janë hartuar nga grupi punues i OIK-ut, në mbështetje të ekspertit dr. Ruzhdi Halili, dhe ekipit të projektit IHS. I njëjti projekt, i financuar nga Swiss Cooperation Development (SDC), mbështeti të gjithë procesin e zhvillimit të Strategjisë.

5. Përmbledhje e gjetjeve nga Raporti i Analizës së Situatës

Kapitulli vijues ofron pasqyrën e përmbledhur të çështjeve për secilën fushë të Strategjisë. Analiza e hollësishme e cila i ka paraprirë hartimit të Strategjisë është përfshirë në Raportin e Analizës së Situatës si një dokument i ndarë nga kjo Strategji. Përmbledhja e mëposhtme si dhe Raporti i Analizës së Situatës janë bazë për drejtimet dhe ndërhyrjet strategjike për periudhën e ardhshme afatmesme të përfshira në këtë Strategji.

5.1. Korniza ligjore e OIK–ut

Që nga themelimi i institucioneve të reja në Kosovë, menaxhimi i profesionistëve të kujdesit shëndetësor ka qenë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Si pjesë e reformave të vazhdueshme në sistemin shëndetësor, themelimi i Odave të Profesionistëve Shëndetësorë ishte mandatuar fillimisht me Ligjin për Shëndetësi nr. 04L/125 (neni 78). Përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë u ndryshuan posaçërisht në vitin 2013 me miratimin e Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor (nr. 04/L–150), i cili ofroi një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse për pesë Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, duke përfshirë OIK–un.

OIK–u është bërë funksional nga data 23.01.2015 në kuvendin e tij të parë. Nga data 31.06.2016 ka filluar bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë, ndërsa bartja e plotë e të gjitha përgjegjësiave nga kjo ministri është bërë më datë 18.01.2018.

Konsiderohet se është bërë avancim substancial në zhvillimin e kornizës ligjore për Odën, me miratimin e rregulloreve dhe akteve të ndryshme që nga themelimi i saj. Rishikimi dhe miratimi i fundit i Statutit në vitin 2024 tregon nevojën për përmirësim të vazhdueshëm legjislativ. Si pasojë, nevojitet harmonizimi i mëtejshëm dhe plotësimi i akteve nënligjore. Disa fusha mbeten ende të parregulluara, duke kërkuar zhvillimin e rregulloreve të reja për prokurimin, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe procedurat për trajtimin e ankesave. Udhëzimet ose procedurat standarde operative mund të ofrojnë gjithashtu udhëzime dhe sqarime për këto çështje.

Korniza ekzistuese ligjore është komplekse për shkak të akteve të shumta, duke e bërë të vështirë zbatimin e saj për anëtarët dhe organet drejtuese. Një proces i thjeshtimit gjatë rishikimit legjislativ mund të rrisë qartësinë dhe të lehtësojë zbatimin. Procesi i hartimit të legjislacionit kërkon analiza gjithëpërfshirëse të politikave dhe konsultime të përshtatshme me palët e interesit, duke përfshirë anëtarët e saj dhe qytetarët e tjerë. Nevojitet një qasje strategjike për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit për të siguruar përafrimin me nevojat e anëtarëve dhe publikut. Oda duhet të forcojë rolin e saj në nismat legjislative, veçanërisht në hartimin e Projektligjit për Shëndetësi, Ligjit për Infermierët dhe harmonizimin e legjislacionit me standardet e BE–së. Ndërtimi i kapaciteteve avokuese dhe ekspertizës profesionale është thelbësor për pjesëmarrjen efektive në hartimin e politikave kombëtare dhe nismat legjislative që prekin përgjegjësitë e Odës.

5.2. Menaxhimi i Odës

Oda e ka detyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve profesionale dhe të rregullojë shumë aspekte për profesionistët e kujdesit shëndetësor. Struktura e saj menaxhuese, siç përcaktohet me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor dhe statutin e saj, përbëhet nga organet, përfshirë Kuvendin, Kryetarin, Këshillin Drejtues, Këshillin Mbikëqyrës, Këshillin e Etikës dhe Gjyqin e Nderit, si dhe Prokurorin e Odës.

Oda përbëhet nga një sërë komisionesh të përhershme si Komisioni për Etikën Profesionale, Komisioni për Licencim; Komisioni për Edukim Specialistik; Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm; Komisioni për Praktikën Profesionale Private; Komisioni për Fondin e Solidaritetit dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa. Gjithashtu, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore ndaj anëtarëve të saj, Këshilli Drejtues ka krijuar një sërë komisionesh të përkohshme.

Kuvendi i OIK–ut është organi më i lartë, i përbërë nga 174 anëtarë të zgjedhur, ndërsa Kryetari mbikëqyrë përputhshmërinë dhe menaxhimin legjislativ të Odës. Këshilli Drejtues, i cili ka autoritetin ekzekutiv, përbëhet

nga anëtarë të zgjedhur dhe të deleguar nga Ministria e Shëndetësisë, duke siguruar përafrimin me interesat e anëtarëve. Këshilli Mbikëqyrës monitoron çështjet financiare dhe profesionale, ndërsa organet e drejtësisë trajtojnë shkeljet etike; megjithatë, aktiviteti i tyre ka qenë i kufizuar, duke sugjeruar nevojën për ndërgjegjësim më të mirë të anëtarëve për proceset e ankesave.

Qeverisja e OIK–ut karakterizohet nga një strukturë komplekse me komisione të shumta që trajtojnë detyra specifike si licencimi dhe buxheti. Megjithatë, mungesa e kriterëve të qarta për krijimin dhe angazhimin e këtyre komisioneve mund të pengojë efektivitetin e tyre. Për më tepër, procesi zgjedhor përballat me sfida në përfaqësimin dhe përfshirjen e kandidatëve, veçanërisht për anëtarët e papunësuar.

Për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, qasja në dokumente kritike ka nevojë për përmirësim. Procesi i hartimit të legjislacionit ka nevojë për rregullim, duke kërkuar një qasje sistematike ndaj analizës së politikave dhe angazhimit të palëve të interesit. Realizimi i anketave për kënaqshmërinë e anëtarëve për punën e Odës mund të nxisë përfshirje më të madhe të anëtarëve dhe reagimin ndaj shqetësimeve që kanë. Për më tepër, një strategji institucionale afatmesme duhet të lehtësojë menaxhimin dhe monitorimin më të mirë të burimeve, duke rritur kështu efektivitetin dhe efikasitetin e përgjithshëm të OIK–ut në përmbushjen e misionit të tij.

5.3. Shërbimi administrativ dhe profesional

Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor ofron bazën ligjore për funksionimin e shërbimit profesional dhe administrativ të Odës. Shërbimi profesional është përgjegjës për detyrat thelbësore administrative, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësorë, mbajtjen e bazave të të dhënave dhe mbështetjen e organeve drejtuese të Odës në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore. Sipas Statutit, organizimi dhe funksionimi i Zyrës Administrative përcaktohet nga një rregullore e miratuar nga Këshilli Drejtues i OIK–ut, me Sekretarin e Përgjithshëm që mbikëqyr funksionet e saj.

Struktura e shërbimit profesional dhe administrativ përfshin njësi të ndryshme, si: Zyra e Financave, Zyra e Anëtarësimit dhe Licencimit, Zyra e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe Etikës dhe Zyra e Çështjeve Ligjore. Çështjet kryesore të identifikuar në analizën e kornizës ligjore përfshijnë se duhet të plotësohet më tej përshkrimi i punës së Sekretarit të Përgjithshëm, të qartësohet ndarja e përgjegjësisë ndërmjet njësive organizative, të sigurohen përshkrimet e punës për pozitat individuale dhe jo vetëm për njësitë, pastaj nevoja për zgjerimin e strukturës me funksionin që lidhet me avokimin dhe komunikimin, të cilat janë funksione jetike për OIK–un, pastaj disa njësi përbëhen nga vetëm një ose dy anëtarë të stafit, pavarësisht se klasifikohen si njësi të veçanta.

Gjithashtu, stafi profesional dhe administrativ duhet të marrë pjesë sistematikisht në programet e trajnimit që synojnë rritjen e aftësive dhe njohurive të tyre. Realizimi i një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave për trajnim mund të identifikojë fushat për zhvillim, duke përfshirë kuptimin e legjislacionit administrativ, menaxhimin financiar, hartimin ligjor dhe avokimin. Përpjekje të tilla për ngritjen e kapaciteteve janë thelbësore për t'ia mundësuar stafit që të kontribuojë në mënyrë efektive në iniciativat e OIK–ut, veçanërisht në hartimin e politikave dhe hartimin e akteve ligjore. Për më tepër, rritja e kapaciteteve të stafit do të forcojë përfshirjen e tyre në aktivitete të jashtme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune apo iniciativa të udhëhequra nga Ministria e Shëndetësisë. Ky angazhim është thelbësor për ruajtjen e kujtesës institucionale dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet OIK–ut dhe organeve të tjera të lidhura me shëndetin publik.

Adresimi i çështjeve të lidhura me strukturën dhe kapacitetet e shërbimit profesional dhe administrativ të OIK–ut është thelbësor për përmirësimin e qeverisjes dhe përmbushjen e misionit të tij për t'u mbështetur standardet profesionale për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë në Kosovë. Duke rritur qartësinë e roleve dhe përgjegjësisë dhe duke investuar në zhvillimin e stafit, OIK–u mund të forcojë pozicionin e tij si lojtar kyç në sistemin e kujdesit shëndetësor, duke kontribuar përfundimisht në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe rezultateve për popullatën.

5.4. Anëtarësimi, licencimi dhe rilicencimi

Anëtarësimi në OIK është i detyrueshëm për të gjithë infermierët, mamitë dhe profesionistët shëndetësorë në Kosovë, siç parashihet në Rregulloren për Regjistrimin dhe Anëtarësimin¹, e miratuar në vitin 2024. Gjithashtu, licencimi dhe rilicencimi që rregullohet me Rregulloren për Licencimin dhe Rilicencimin e Profesionistëve² të OIK–ut janë përgjegjësi fundamentale të OIK–ut. Ky proces lehtësohet përmes një platforme digjitale për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë, duke lejuar procedura efikase të aplikimit elektronik, anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit.

OIK–u përbëhet nga komuniteti më i madh i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Kosovë, me numrat e raportuar të anëtarësimit që luhaten ndjeshëm gjatë viteve. Oda pretendon se ka mbi 20,000 anëtarë³, por statistikave zyrtare paraqesin mospërputhje: Raporti i Statistikave Shëndetësore i vitit 2020 dokumentoi 16,415 anëtarë, ndërsa raporti i vitit 2022 tregoi rritje në 30,386. Deri në vitin 2023, numri kishte rënë në 16,134. Kjo mospërputhje nxjerr në pah nevojën për sqarim dhe përcjellje të përmirësuar të statistikave të anëtarësimit. Anëtarët klasifikohen si aktivë ose pasivë, por një proces i plotë identifikimi i brendshëm nuk është kryer që nga viti 2019.

Vetëm në vitin 2023, 4,838 profesionistë shëndetësor iu bashkuan OIK–ut, duke reflektuar sfidat e vazhdueshme të Odës. Të dhënat e anëtarësimit, duke përfshirë listat e profesionistëve të licencuar, janë dokumente publike sipas ligjit dhe duhet të jenë të qasshme në faqen e internetit të Odës, e cila rekomandohet për transparencë të shtuar. Anëtarësia në OIK është e larmishme, duke përfshirë afërsisht 65 profile të ndryshme profesionale, ku shumica janë infermierë dhe mami. Megjithatë, raporti i infermierëve në Kosovë prej 4.1 për 1000 banorë është më i ulët se mesatarja e BE–së prej 9.7 dhe gjithashtu më i ulët se shumica e vendeve fqinje, ku vetëm Maqedonia e Veriut (3.7) ka një raport më të ulët⁴.

Rregullorja për Licencimin dhe Rilicencimin e Profesionistëve të OIK–ut, e cila u miratua në vitin 2024, përcakton se marrja e licencës është e detyrueshme pas anëtarësimit dhe kërkon që kandidatët të kenë një diplomë të akredituar ose t'i plotësojnë kualifikimet përkatëse arsimore. Aktualisht, vetëm licencimi dhe rilicencimi i psikologëve klinikë adresohet me rregullore të veçantë. Çdo licencë mbetet e vlefshme për pesë vjet, gjatë të cilës profesionistët duhet të grumbullojnë të paktën 100 pikë kredie për arsim të vazhdueshëm që të kualifikohen për rilicencim.

Një nga sfidat e rëndësishme me të cilat ballafaqohet OIK–u është numri i madh i aplikimeve për licencim dhe rilicencim. Në vitin 2023, Oda përpunoi 5,284 licenca të reja dhe 5,950 aplikime për rilicencim, që përbën një ngarkesë të konsiderueshme pune për organet e saj⁵. Ky vëllim i lartë ngre shqetësime për kapacitetin e Odës për të shqyrtuar dhe verifikuar në mënyrë adekuate dokumentacionin për të gjithë aplikantët, veçanërisht në lidhje me aktivitetet e tyre të zhvillimit profesional.

Për t'i menaxhuar profilet e ndryshme të anëtarëve të saj, Oda ka krijuar komitete të specializuara licencimi, duke përfshirë anëtarë të Kuvendit dhe profesionistë të jashtëm. Megjithatë, sfida është monitorimi i cilësisë në kuadër të procesit të licencimit, ndërkohë që nevojiten kritere dhe udhëzime më të qarta për krijimin dhe funksionimin e këtyre komiteteve.

Shpërndarja e anëtarëve të licencuar dhe të rilicencuar ndryshon gjerësisht në profile të ndryshme profesionale, me një përqendrim të konsiderueshëm në kategoritë e infermierisë, që përbënin 69% të të gjithë

1 Rregullorja për Regjistrimin dhe Anëtarësimin e Profesionistëve të OIK https://oik-ks.org/wp-content/uploads/2024/08/2024.06.28_Rregullorja-per-Regjistrim-dhe-Antaresim.pdf

2 Rregullorja për Licencimin dhe Rilicencimin e Profesionistëve të OIK https://oik-ks.org/wp-content/uploads/2024/08/2024.06.28_Rregullorja-per-Licensim-dhe-Ri-licensim.pdf

3 Informacioni u deklarua në takimin me OIK, të mbajtur më 27–28 shtator 2024.

4 Të dhënat më të fundit nga Banka Botërore të përditësuara në vitin 2021, të marra nga drafti i Strategjisë Shëndetësore, në dispozicion në: <https://konsultimet.rks-qov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42622>

5 Të dhënat nga Raporti Vjetor i OIK–ut për vitin 2023.

anëtarëve të licencuar dhe të rilicencuar në vitin 2023. Nga ana tjetër, në disa profile, si asistentët ortopedikë dhe teknikët optikë, kishte vetëm pak anëtarë të rinj.

Oda përballet edhe me sfida lidhur me aplikantët kualifikimet e të cilëve janë të akredituar nga institucione të panjohura nga Ministria e Shëndetësisë. Shumë aplikantë nga këto programe refuzohen për shkak se OIK-u është i autorizuar për t'i licencuar vetëm profilet e njohura në regjistrin zyrtar të lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë. Kjo çështje nxjerr në pah nevojën për bashkëpunim ndërmjet akterëve të shumtë, duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Odat Profesionale Shëndetësore, për të krijuar një mekanizëm gjithëpërfshirës për njohjen dhe licencimin.

Ndërsa proceset për anëtarësim, licencim dhe rilicencim janë digjitalizuar përmes një Platforme Digjitale për Menaxhimin e Profesionistëve të Kujdesit Shëndetësor, sistemi aktualisht nuk mund të gjenerojë raporte statistikore të automatizuara. Ky kufizim kërkon trajtimin manual të të dhënave, që mund të ndikojë në vendimmarrjen dhe menaxhimin efektiv. Për të rritur efikasitetin operacional, përmirësimet në aftësitë e përpunimit të të dhënave të platformës janë thelbësore, veçanërisht për gjurmimin e skadimit të licencave dhe menaxhimin e statusit të anëtarësimit.

5. 5. Edukimi i vazhdueshëm profesional

Kujdesi për zhvillimin dhe funksionimin e profesionit të infermierisë, mamisë dhe profesioneve të tjera shëndetësore mbetet një nga detyrat themelore të Odës. Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësor i mandaton profesionistët e kujdesit shëndetësor që të angazhohen në zhvillim të vazhdueshëm profesional për të ruajtur dhe rritur kualifikimet e tyre profesionale dhe parasheh obligimin për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Duke theksuar rëndësinë e këtij procesi, ligji kërkon që institucionet shëndetësore të lehtësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional nga ana e Odës bëhet nëpërmjet akreditimit të programeve të zbatuara nga operatorë të ndryshëm, si dhe akreditimit dhe ofrimit të aktiviteteve të kryera nga vetë Oda. Sigurimi që profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të angazhuar vazhdimisht në zhvillim profesional arrihet përmes pikëve kreditore (20 pikë kredi duhet të merren çdo vit, në total 100 pikë kreditore brenda 5 viteve). Përgjegjësia për grumbullimin e pikëve kreditore përmes programeve të akredituara i takon profesionistit të kujdesit shëndetësor, ndërsa përgjegjësia e Odës është të sigurojë që profesionistëve të kujdesit shëndetësor t'u ofrohen programe të mjaftueshme për të ndjekur për ruajtjen e njohurive dhe aftësive të tyre profesionale si dhe për marrjen e pikëve të nevojshme. Programet e edukimit të vazhdueshëm profesional ofrohen nga vetë Oda dhe nga institucionet publike shëndetësore ku janë të punësuar profesionistë shëndetësorë. Megjithatë, programet e edukimit të vazhdueshëm të cilat janë të akredituara nga Oda ofrohen nga institucione të ndryshme arsimore profesionale që vijnë nga shoqëria civile apo sektori privat.

Viteve të fundit, OIK-u ka avancuar ndjeshëm angazhimin e tij për ofrimin e programeve të akredituara, duke organizuar sesione gjatë pranverës dhe vjeshtës, personalisht dhe online. Në vitin 2023, iniciativat e trajnimit të Odës mbuluan 6,207 pjesëmarrës. Megjithatë, sfida mbetet të sigurohet që këto aktivitete të mos jenë thjesht procese formale për përmbushjen e kërkesave rregullatore.

Oda bashkëpunon ngushtë me institucionet publike të kujdesit shëndetësor për t'i akredituar programet e tyre të trajnimit dhe për t'i vlerësuar nevojat për zhvillim profesional të stafit të tyre. Deri më sot, OIK-u ka akredituar 184 programe të zhvillimit të vazhdueshëm, duke lëshuar 17,427 certifikata elektronike dhe 22,134 në kopje fizike. Megjithatë, qasja aktuale nga poshtë-lart për akreditimin e programit nuk përputhet gjithmonë me nevojat e profesionistëve shëndetësorë, duke ngritur shqetësime në lidhje me rëndësinë e trajnimit të ofruar. Ndërsa zhvillohen planet vjetore të zhvillimit të vazhdueshëm, rekomandohet një cikël i planifikimit më strategjik trevjeçar për t'i identifikuar dhe adresuar në mënyrë sistematike nevojat për trajnim.

Oda gjithashtu monitoron cilësinë e aktiviteteve të programeve të zhvillimit të vazhdueshëm përmes anëtarëve të caktuar; megjithatë, vëllimi i aktiviteteve paraqet sfida për sigurimin e qëndrueshëm të cilësisë. Përderisa

OIK-u ka bërë përpjekje të konsiderueshme për lehtësimin e programeve të zhvillimit të vazhdueshëm, ai duhet të miratojë një qasje më strategjike për vlerësimin e nevojave, akreditimin e programit dhe monitorimin e cilësisë për të rritur zhvillimin profesional të anëtarëve të tij dhe për t'i përmirësuar shërbimet e kujdesit shëndetësor në Kosovë.

5. 6. Digjitalizimi

Oda ka zhvilluar një platformë të avancuar elektronike që ofron një sërë shërbimesh esenciale për anëtarët e saj, duke përfshirë procedurat e aplikimit për anëtarësim, licencimin, rilicencimin dhe akreditimin e programeve të edukimit të vazhdueshëm⁶. Kjo platformë digjitale i lejon anëtarët t'i kryejnë të gjitha proceset në mënyrë elektronike, duke siguruar efikasitet dhe qasje. Për më tepër, Oda përdor faqen e saj zyrtare të internetit⁷ dhe kanalet e rrjeteve sociale, si Facebook⁸, për të shpërndarë informata rreth aktiviteteve, dokumenteve dhe shërbimeve të saj.

Pavarësisht avancimeve të bëra, ende mbeten shumë mundësi për të përmirësuar komunikimin dhe efikasitetin operacional të Odës përmes teknologjisë. Përmirësimet e mundshme në faqen e internetit të OIK-ut dhe platformën digjitale mund të përfshijnë:

- Lehtësimin e konsultimeve të dyanshme gjatë proceseve politike dhe legjislative.
- Krijimin e kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit me anëtarët.
- Zbatimin e mjeteve të anketimit për t'i matur perceptimet dhe kënaqshmërinë e publikut.
- Ofrimin e opsioneve të paraqitjes elektronike për ankesat dhe raportimin e shkeljeve të Kodit të Etikës.
- Ofrimin e burimeve arsimore dhe materialeve mësimore në internet.

Për më tepër, kapaciteti i platformës për të gjeneruar informacione dhe statistika kyçe për raportimin dhe vendimmarrjen ka nevojë që të përmirësohet, gjë që do të rriste efektivitetin menaxherial të Odës dhe menaxhimin e përgjithshëm të të dhënave. OIK-u duhet gjithashtu të konsiderojë integrimin e shërbimeve të tij në portalin digjital shtetëror e-Kosova⁹ dhe t'i eksplorojë lidhjet me sisteme të tjera zyrtare të të dhënave, si regjistri i gjendjes civile, regjistri i të punësuarve, regjistri i administratës tatimore etj.

6 Shikoni platformën në dispozicion në: <https://oik-ks.org/licencimi/licencimi-me-shkollim-te-mesem-larte/>

7 Shih faqen e internetit të OIK-ut: <https://oik-ks.org>

8 Faqja në Facebook e Odës: <https://www.facebook.com/OdaInfermiereKosoves>

9 Shihni platformën e-Kosova: <https://ekosova.rks-gov.net>

6. Analiza SWOT për OIK-un

Përparësitë	Dobësitë
- Oda ka një strukturë qeverisjeje të vendosur mirë. - Korniza ligjore e kompletuar dhe e avancuar. - Pavarësia në vendimmarrje. - Procedura të përcaktuara mirë. - Platformë e avancuar digjitale për ofrimin e shërbimeve. - Qëndrueshmëria financiare e OIK-ut. - Përfshirja në rrjetet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e bashkëpunimit. - Përfaqësim i llojlojshëm (anëtarësi e gjerë me shumë profile). - Eksptertizë profesionale (fuqi punëtore e kualifikuar me njohuri). - Përkushtimi i plotë i OIK-ut për të siguruar kujdes cilësor.	- Koordinim i pamjaftueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë, MASHTI-n, AKA-në, QKUK-në. - Nevoja për të rritur ndërgjegjësimin për rolin e OIK-ut. - Struktura dhe funksionimi kompleks i qeverisjes. - Nevojitet rishikimi i Kodit të Etikës. - Planifikimi dhe zhvillimi legjislativ i bazuar në politika. - Disa dokumente nuk janë të qasshme. - Ekziston nevoja për zgjerimin e burimeve njerëzore, mjeteve, teknikave, kapaciteteve dhe aktiviteteve avokuese. - Ndërgjegjësim i kufizuar. - Të dhëna dhe prova të pamjaftueshme për të nxitur avokimin. - Kufizime financiare për qëllime avokimi. - Komunikim i kufizuar. - Ndërveprim/promovim i ulët mediatik. - Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime avokimi.
Mundësitë	Rreziqet
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët e tjerë. - Përmirësimi i përdorimit të teknologjive të reja. - Përfshirja në hartimin e politikave kombëtare dhe hartimin e legjislacionit. - Zbatimi i një qasjeje strategjike për planifikimin afatmesëm dhe strategjinë institucionale. - Zhvillimi i dëshmime bindëse për t'i nxitur iniciativat e avokimit. - Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe mbështetjes për avokim me ndikim. - Rritja e financimit për t'i mbështetur veprimet e avokimit. - Përparimi i teknologjisë për të komunikuar me sukses avokimin. - Zhvillimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit (bashkëpunimi ndërkombëtar). - Rritja e pranisë në media. - Zhvillimi i kërkimit për marrjen e informacionit dhe marrjen e iniciativave.	- Shkeljet e Kodit të Etikës nga anëtarët mund të dëmtojnë besimin tek Oda. - Trajtimi i pabarabartë në kompensimin e infermierëve dhe kategorive të tjera në sektorin publik mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve të tyre. - Rezistenca e qeverisë ndaj miratimit të nismave të propozuara legjislative, si Projektligji për Infermierinë, apo trajtimi i pabarabartë në kompensimin e anëtarëve në sektorin publik mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve të tyre. - Çështjet e transparencës mund të pengojnë besimin e partnerët të Odës. - Rezistenca e organeve vendimmarrëse me ndikim. - Ndryshimet në legjislacion që prekin interesat e Odës. - Mungesa e koordinimit të mirëfilltë ndërmjet institucioneve me ndikim që mund të pengojnë dhe vonojnë proceset. - Mospërfshirja e përfaqësuesve të OIK-ut në grupet e punës të institucioneve për hartimin e dokumenteve që lidhen me përgjegjësitë e tij. - Mospërfaqësimi i infermierëve dhe profesionistëve të tjerë në strukturat drejtuese në institucionet shëndetësore.

7. Misioni dhe vizioni

7.1. Misioni i OIK–ut

Misioni i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë është mbrojtja dhe prezantimi i interesave profesionale të anëtarëve të saj, sigurimi i standardeve të larta të Kodit të Etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovimi dhe mbrojtja e veprimtarisë së profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe ato private, sigurimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për të ofruar shërbime shëndetësore sa më cilësore dhe shërbime të tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor në ruajtjen e shëndetit të popullatës.

7.2. Vizioni i OIK–ut

Vizioni i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë është që të jetë një institucion lider që frymëzon përsosmëri për anëtarët e saj, duke siguruar standardet më të larta të kujdesit dhe ndërtimin e besimit publik përmes qeverisjes efektive, efikase, transparente dhe të përgjegjshme dhe ofrimit të shërbimeve profesionale. Oda synon të ofrojë zhvillim profesional dhe të jetë forcë shtytëse në avancimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke avokuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe duke siguruar ofrimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët.

8. Objektivat strategjike

8.1. Korniza ligjore e OIK–ut

Objektivi strategjik 1. Kornizë legjislativ e avancuar dhe gjithëpërfshirëse për OIK–un, duke siguruar që zhvillimi legjislativ të bazohet në analiza, vendimmarrje të bazuar në politika dhe konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit për t'i përmbushur nevojat e Odës dhe anëtarëve të saj.

Objektivi specifik 1.1. Rishikimi, plotësimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore me Statutin dhe kornizën tjetër përkatëse ligjore, duke thjeshtuar dhe kodifikuar dispozitat përkatëse për të reduktuar kompleksitetin, për t'i minimizuar mospërputhjet dhe për të rritur qartësinë dhe lehtësuar qasjen.

Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi i politikave si bazë për të gjitha proceset e hartimit dhe rishikimit legjislativ.

Objektivi specifik 1.3. Avancimi i përfshirjes dhe konsultimit të palëve të interesit në hartimin e legjislacionit të OIK–ut.

Objektivi specifik 1.4. Avancimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e legjislacionit të Odës dhe përmirësimi i mjeteve për informimin, drejtimin dhe lehtësimin e zbatimit të legjislacionit për organet e Odës dhe anëtarët e saj.

Arritja e këtyre objektivave do të matet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

5. Përqindja e akteve të Odës që janë të harmonizuara me Statutin dhe kornizën ligjore përkatëse.
6. Numri i dokumenteve të politikave të hartuara për të shërbyer si bazë për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit.
7. Përqindja e dokumenteve të konsultuara për të cilat publikohen raportet e konsultimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të procesit të konsultimit.
8. Numri i raporteve të monitorimit të hartuara çdo vit për zbatimin e akteve legjislativ.

Objektivi specifik 1.1. Rishikimi, plotësimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore me Statutin dhe kornizën tjetër përkatëse ligjore, duke thjeshtuar dhe kodifikuar dispozitat përkatëse për të reduktuar kompleksitetin, për t'i minimizuar mospërputhjet dhe për të rritur qartësinë dhe lehtësuar qasjen.

Pas miratimit të Statutit të OIK–ut, shqyrtimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese të Odës me Statutin dhe aktet e tjera ligjore, si dhe miratimi i akteve të reja, janë faktorë thelbësorë për avancimin e punës së Odës. Rishikimi i akteve ekzistuese dhe hartimi i akteve të reja kërkon angazhimin dhe ndarjen e kohës dhe burimeve të mjaftueshme të Odës. Duke qenë se numri i akteve që duhet të miratohen nga Kuvendi i Odës dhe të hartohen nga organet e tjera përgjegjëse pritet të jetë i konsiderueshëm, planifikimi i aktiviteteve legjislativë është i nevojshëm. Strategjia dhe Plani i Zbatimit të saj do të jenë instrumentet kryesore nëpërmjet të cilave do të kryhet renditja dhe planifikimi i hartimit të akteve që do të miratohen për të paktën 3 vitet e ardhshme, siç mbulohet nga Plani i detajuar i Zbatimit.

Prandaj, Plani i Zbatimit për këtë Strategji për periudhën e ardhshme mbulon masat e mëposhtme:

- Rishikimi i rregulloreve si Kodi i Etikës, Rregullorja për Prokurorin e Odave dhe Rregullorja për Gjykatën e Nderit (ndoshta një kornizë rregullatore e integruar për Këshillin e Etikës, Gjykatën e Nderit dhe Prokurorin), Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të Shërbimit Profesional i cili duhet të mbulojë të gjitha organet e Odës, miratimi i Kodit të ri Zgjedhor etj.
- Hartimi i akteve të reja si rregullore për procedurat e prokurimit, rregullore për vendosjen e marrëdhënieve të punës dhe aspekte tjera të menaxhimit të stafit për stafin profesional dhe administrativ.
- Oda do të aktivizohet në bashkëpunim me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore në përcaktimin e listës së shërbimeve dhe listës së çmimeve për shërbimet e infermierisë dhe shërbimet e tjera përkatëse të profesionistëve shëndetësorë. Bashkëpunimi synon të rezultojë në ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2024 – Bashkëpagesat për Shërbimet Shëndetësore, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Zhvillimi i udhëzimeve, manualeve ose procedurave standarde operative. Fushat që mund të mbulohen këtu janë procedurat e zhvillimit të politikave dhe legjislativit, qartësimi i procedurave për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave nga anëtarët e Odës dhe nga qytetarët, detajet lidhur me punën e prokurorit dhe organeve të tjera disiplinore.

Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi i politikave si bazë për të gjitha proceset e hartimit dhe rishikimit legjislativ.

Një nga segmentet dhe parakushtet më të rëndësishme për legjisllacion cilësor është që hartimi i tij të bazohet dhe të paraprihet në evidencë, analizë dhe rishikim të alternativave të politikave. Ky proces zakonisht është kryer nga organet e Odës, pasi çdo akt legjislativ është hartuar në bazë të nevojave të identifikuara nga Oda. Megjithatë, avancimi dhe formalizimi i procesit të mbledhjes së informacionit, kryerjes së analizave, rishikimit dhe dokumentimit të tij është i nevojshëm. Duke qenë se ky proces kërkon kapacitete specifike dhe kërkon kohë, përpjekjet për përmirësimin e një përqasjeje të tillë do të shtrihen në një periudhë më të gjatë, fillimisht fokusi do të përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin dhe qartësimin e procedurave dhe përcaktimin e roleve të strukturave përgjegjëse të OIK–ut dhe në fund zhvillimin e një numri minimal të dokumenteve të politikave për rregulloret që do të hartohen. Si rezultat, masat për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Hartimi i udhëzimeve dhe procedurave për zhvillimin dhe analizën e politikave brenda Odës.
- Zhvillimi i një analize para–hartuese për aktet e Odës.
- Trajnimi i stafit të Odës për të kryer analiza të politikave.
- Takime të rregullta me profesionistë të kujdesit shëndetësor (në fusha të përfaqësuara nga Oda) për t'i identifikuar nevojat zhvillimore të Odës.

Objektivi specifik 1.3. Avancimi i përfshirjes dhe konsultimit të palëve të interesit në hartimin e legjislacionit të OIK–ut.

Një aspekt i rëndësishëm për të siguruar legjislacion cilësor dhe qeverisje të duhur është përfshirja dhe pjesëmarrja e palëve të interesit në procesin e hartimit të legjislacionit, veçanërisht e anëtarëve dhe subjekteve që përfaqësojnë interesat e tyre, si dhe aktorëve të tjerë si: organizatat joqeveritare, ofruesit e aktiviteteve arsimore etj. Në periudhë afatmesme, Oda do të angazhohet në përmirësimin e procesit nëpërmjet masave të mëposhtme:

- Përfshirja e palëve të interesit dhe ekspertëve të përzgjedhur në procesin e hershëm të hartimit përmes grupeve të punës dhe konsultimeve publike të të gjitha akteve që janë të hartuara nga Oda.
- Sqarimi i kërkesave për përzgjedhjen e palëve të interesit, metodat që do të përdoren për konsultimin publik dhe informimi i palëve të interesit dhe publikut të konsultuar për rezultatet e procesit të konsultimit.
- Avancimi i mjeteve elektronike, ndër të tjera, do të jetë një nga segmentet për përmirësim të mëtejshëm. Seksioni i konsultimit publik, në faqen e internetit të OIK–ut, është një nga mjetet. Përmirësimi i tij ku, përveç publikimit të dokumenteve për konsultim, jepen informacione të tjera, si p.sh. se si palët e interesit mund të paraqesin komente, publikohen raporte të konsultimit dhe detaje mbi procesin e konsultimit dhe komentet e marra.

Objektivi specifik 1.4. Avancimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e legjislacionit të Odës dhe përmirësimi i mjeteve për informimin, drejtimin dhe lehtësimin e zbatimit të legjislacionit për organet e Odës dhe anëtarët e saj.

Zbatimi i legjislacionit të Odës është faktori kyç përmes të cilit arrihen objektivat e Odës. Monitorimi i zbatimit është një segment thelbësor për t'u informuar nëse legjislacioni po zbatohet. Gjatë periudhës afatmesme të ardhshme, Oda do të fokusohet në rritjen e aktiviteteve për avancimin e sistemit të monitorimit për zbatimin e akteve të miratuara nga Oda. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, Oda synon të rrisë vëllimin e aktiviteteve që synojnë t'i informojnë anëtarët dhe palët e tjera të prekura për të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe të ofrojë udhëzime të qarta për segmente të veçanta të legjislacionit ekzistues apo të ri. Miratimi i manualeve, udhëzimeve dhe procedurave standarde operative për aspekte të veçanta të legjislacionit janë disa nga instrumentet për të siguruar arritjen e këtij objekti. Gjithashtu, Oda do të rrisë kapacitetet e shërbimit të saj ligjor në monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit. Për të arritur këtë qëllim, Oda do të shqyrtojë bashkëpunimin me Institutin e Administratës Publike të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë dhe institucione dhe donatorë të tjerë potencialë për arritjen e bashkëpunimit, përmes të cilit stafit profesional të Odës do t'i mundësohet pjesëmarrja në trajnimet e organizuara prej tyre. Gjithashtu, pas miratimit të akteve të Odës, përveç bërjes së tyre të qasshme, Oda synon të organizojë edhe aktivitete promovuese, informuese dhe udhëzuese me anëtarët dhe palët e tjera të prekura. Si rezultat, masat për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Zhvillimi i aktiviteteve me anëtarët e saj pas miratimit të çdo rregulloreje për të informuar, drejtuar dhe lehtësuar zbatimin e legjislacionit.
- Kryerja e vlerësimeve për zbatimin e akteve të veçanta të Odës.
- Trajnimi i stafit të Odës në monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit.
- Publikimi i materialeve udhëzuese të përditësuara, përfshirë dokumente mbështetëse, video, etj., për zbatimin e legjislacionit.
- Hartimi i dokumentit “Karta e Infermierisë”.
- Hartimi i dokumentit “Karta e Mamisë”.

8.2. Qeverisja dhe shërbimi profesional

Objektivi strategjik 2. Sigurimi i qeverisjes efektive, efikase, transparente dhe llogaridhënese dhe shërbimi profesional administrativ i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë

Objektivi specifik 2.1. Avancimi i sistemit të planifikimit afatmesëm të Odës, duke përfshirë planifikimin afatmesëm të punës, atë financiar dhe buxhetor, për t'i harmonizuar më mirë burimet me prioritetet strategjike.

Objektivi specifik 2.2. Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar që dokumentet kyçe si aktet legjislative, planet e punës, planet financiare dhe raportet e auditimit të jenë lehtësisht të qasshme në faqen e internetit të OIK–ut, duke aplikuar gjithashtu rregullisht mekanizma për të marrë komente kthyes (feedback) nga anëtarët dhe palët e tjera të interesit që përfitojnë nga shërbimet e profesionistëve shëndetësorë.

Objektivi specifik 2.3. Avancimi i strukturës së brendshme dhe proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Odës.

Objektivi specifik 2.4. Rritja e zhvillimit profesional duke zbatuar programe trajnimi për shërbimin profesional dhe stafin menaxherial për t'i përmbushur nevojat në zhvillim të Odës dhe anëtarëve të saj.

Arritja e këtyre objektivave do të matet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

5. Të gjitha rregulloret, planet, raportet dhe informacionet tjera relevante të Odës publikohen në faqen e internetit të institucionit.
6. Niveli i kënaqshmërisë së anëtarëve me punën e Odës.
7. Niveli i kënaqshmërisë së pacientëve me punën e anëtarëve të Odës.

Objektivi specifik 2.1. Avancimi i sistemit të planifikimit afatmesëm të Odës, duke përfshirë planifikimin afatmesëm të punës, atë financiar dhe buxhetor, për t'i harmonizuar më mirë burimet me prioritetet strategjike.

Planifikimi i ardhshëm i cili ia mundëson institucionit t'i parashikojë të ardhurat dhe t'i planifikojë ato në kohën e duhur, si dhe ndarja në kohë e burimeve, është një mjet vendimtar për qeverisje efektive dhe efikase. Për më tepër, një planifikim i tillë ndihmon në përmirësimin e kapacitetit për t'u përgjigjur sfidave dhe kërkesave të reja, duke rritur fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë e institucionit. Gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, Oda synon të avancojë sistemin e saj të planifikimit për të siguruar harmonizim më efektiv të burimeve me prioritetet strategjike. Kjo përfshin rritjen e mekanizmave për planifikimin afatmesëm të punës, menaxhimin financiar dhe parashikimin e buxhetit për të siguruar që burimet të ndahen në mënyrë efikase dhe transparente në mbështetje të objektivave dhe misionit të Odës.

Plani për Zbatimin e kësaj Strategjie, si një dokument pesëvjeçar, do të jetë instrumenti kryesor që do të mbështesë procesin e planifikimit afatmesëm në Odë. Plani do të zbërthehet dhe përditësohet me aktivitete të detajuara sipas nevojave në zhvillim përmes planeve vjetore. Për më tepër, financiare dhe planifikimi buxhetor, i cili synohet të zhvillohet në afat të mesëm, do të mbështesë Planin e Zbatimit dhe gjithashtu do të përfshijë projeksionet e shpenzimeve buxhetore dhe parashikimet financiare për Odën për tri vitet e ardhshme. Në këtë kontekst, Oda do të punojë për të siguruar që burimet financiare të ndahen në një mënyrë që të maksimizojë ndikimin dhe të mbështesë qëndrueshmërinë afatgjatë të aktiviteteve të saj.

Masat për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Miratimi i udhëzuesit për procesin e zhvillimit dhe formatimit të dokumenteve të planifikimit afatmesëm.
- Hartimi i dokumentit të planifikimit buxhetor afatmesëm.
- Përgatitja e raportit periodik të shpenzimeve të Odës.
- Sigurimi i trajnimeve dhe kurseve të rregullta për stafin profesional në menaxhimin financiar dhe të projekteve.

Objektivi specifik 2.2. Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar që dokumentet kyçe si aktet legjislative, planet e punës, planet financiare dhe raportet e auditimit të jenë lehtësisht të qasshme në faqen e internetit të OIK–ut, duke aplikuar gjithashtu rregullisht mekanizma për të marrë komente kthyese (feedback) nga anëtarët dhe palët e tjera të interesit që përfitojnë nga shërbimet e profesionistëve shëndetësorë.

Komponentët thelbësorë për një qeverisje të mirë dhe efektive janë parimet e transparencës dhe llogaridhënies së një institucioni. Në përputhje me këto parime, Oda përbëhet nga organe që synojnë të sigurojnë kontrole dhe balancim të përgjegjësive dhe vendimmarrjes, duke siguruar njëkohësisht edhe përfaqësimin e anëtarëve të saj përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Për më tepër, janë krijuar mjete që synojnë ta bëjnë punën e Odës transparente për anëtarët dhe qytetarët. Megjithatë, si nevojat e publikut ashtu edhe mjetet me të cilat ndahet informacioni me palët e interesit dhe publikun po evoluojnë çdo ditë. Prandaj, avancimi i mjeteve të tilla është gjithmonë i nevojshëm. Si rezultat, avancimi i faqes së internetit të Odës dhe platformës elektronike duke përmirësuar komponentin e gjenerimit të informacionit dhe statistikave mund të mundësojë raportim dhe analizë të lehtë të informacionit. Faqja e internetit synon gjithashtu të zgjerojë publikimin e të gjitha akteve ligjore që lidhen me punën e Odës dhe anëtarëve të saj, duke përfshirë aktet e miratuara nga Oda, planet e punës, planet buxhetore, raportet e punës, raportet buxhetore dhe dokumentet e tjera me interes për anëtarët e Odës dhe publikun. Dokumentet dhe informacionet e publikuara synohen të jenë lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme për përdoruesit.

Përveç këtyre përpjekjeve, përdorimi i mjeteve të ndryshme për t'ua mundësuar anëtarëve dhe publikut që të kontribuojnë aktivisht në përmirësimin e funksionimit të Odës do të jetë shumë i dobishëm. Një nga mjetet është zhvillimi dhe administrimi i rregullt i anketave të kënaqshmërisë së anëtarëve, të cilat mund të shërbejnë si një barometër thelbësor për t'i kuptuar nevojat, shqetësimet dhe pritshmëritë e anëtarësimit. Anketat e kënaqshmërisë do të kryhen me pacientët për t'i marrë komentet e tyre për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët e Odës, si dhe respektimin e Kodit të Sjelljes nga ana e tyre. Është gjithashtu e rëndësishme të krijohen mekanizma të qartë që mundësojnë adresimin e çështjeve të identifikuara përmes anketave dhe mjeteve të tjera të mbledhjes së informacionit, duke siguruar që reagimet të përkthehen në veprime dhe përmirësime kuptimplote.

Për më tepër, ky mekanizëm reagimi do të përdoret jo vetëm për të avancuar funksionimin e brendshëm të Odës, por edhe për t'i mbështetur përpjekjet avokuese të Odës. Duke mbledhur njohuri, opinione dhe shqetësime nga anëtarët e saj, Oda do të pozicionohet më mirë për t'i përfaqësuar interesat e tyre në politikatat dhe nismat legjislative të ndërmarra nga qeveria. Një reagim i tillë mund të ndihmojë në formimin e pozicionit të Odës për reformat thelbësore të lidhura me shëndetin, duke forcuar kështu rolin e saj si zë kyç në sektorin e shëndetësisë. Nëpërmjet këtyre mjeteve, Oda do të nxisë një angazhim, transparencë dhe gjithëpërfshirje më të madhe, duke ndërtuar besim si me anëtarët e saj ashtu edhe me publikun në përgjithësi. Për të arritur këtë qëllim mund të shfrytëzohet avancimi i faqes elektronike dhe platformës elektronike të Odës. Gjithashtu, Oda mund të përdorë mjete të tjera për shkëmbimin dhe marrjen e informacionit ndërmjet Odës dhe anëtarëve të saj, si takime dhe kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet anëtarëve, shoqatave që i përfaqësojnë ata, ofruesve të shërbimeve të edukimit të vazhdueshëm profesional, etj.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Publikimi i të gjitha dokumenteve legjislativë, planeve dhe materialeve të tjera në faqen e internetit të Odës.
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për ngritjen e komisioneve të Odës.
- Hartimi i një udhëzuesi për zhvillimin e anketave.
- Kryerja e një ankete të kënaqshmërisë së anëtarëve në lidhje me punën e Odës.
- Kryerja e një ankete të kënaqshmërisë së qytetarëve në lidhje me punën e anëtarëve të Odës.
- Krijimi i një mekanizmi online për mbledhjen e vazhdueshme të komenteve nga anëtarët dhe palët e interesit për punën e Odës.
- Planifikimi i mbikëqyrjes vjetore të aktiviteteve të Odës.
- Hartimi i raporteve vjetore të mbikëqyrjes së brendshme.

Objektivi specifik 2.3. Avancimi i strukturës së brendshme dhe proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Odës.

MShërbimi profesional dhe administrativ është mekanizmi kryesor që mbështet punën e organeve të Odës, prandaj organizimi i duhur, kuadri i mjaftueshëm dhe avancimi i kapaciteteve të stafit aktual janë thelbësorë për punën e Odës. Organizimi i brendshëm i shërbimit profesional dhe administrativ, përgjegjësitë e çdo njësie organizative si dhe përshkrimet e punës së personelit individual mbulohen nga Rregullorja për Organizimin e Shërbimit Profesional dhe Administrativ, miratuar më 07.04.2023. Analiza e situatës dhe strukturës aktuale të Odës, e rregulluar me këtë rregullore dhe e realizuar për qëllimet e kësaj Strategjie, nxjerr në pah nevojën e rishikimit të saj, dhe për këtë arsye Strategjia synon t'i adresojë çështjet e mëposhtme:

- Rishikimi i Rregullores për Shërbimin Profesional dhe Administrativ. Rregullorja e re pritet të trajtojë dhe të përfshijë një ndarje të qartë të përgjegjësiave ndërmjet njësive në shërbimin profesional dhe administrativ, pasi ato përcaktohen aktualisht vetëm përmes përshkrimeve individuale të vendeve të punës. Rishikimi do të marrë në konsideratë ngritjen e çdo njësie apo personeli të ri dhe do të fokusohet në përmirësimin e mëtejshëm të kriterëve dhe kërkesave për pozita. Kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 06/L –113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura¹⁰ dhe modelet e rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ministri do të shërbejnë si modele për rregullimin e organizimit të brendshëm të Odës dhe organizimin e shërbimit administrativ dhe profesional të saj. Përveç shërbimit profesional dhe administrativ, rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për OIK-un do t'i përfshijë të gjitha organet e Odës.
- Krijimi i një funksioni dhe një personeli të përkushtuar për avokim dhe komunikim do të merret parasysh gjithashtu, duke pasur parasysh rëndësinë e angazhimit të palëve të interesuara të theksuara në raport.
- Rivlerësimi i strukturës ku disa zyra, megjithëse konsiderohen si njësi, përbëhen nga vetëm një ose dy punonjës. Shpërndarja më e balancuar e personelit nëpër njësi mund të përmirësojë efektivitetin dhe efikasitetin.
- Këshillohet që përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm të përcaktohen në lidhje me kompetencat vendimmarrëse, si autoriteti mbi emërimet, masat disiplinore, vlerësimet e performancës, shkarkimet e stafit për stafin profesional dhe administrativ.
- Plotësimi i pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm për të siguruar drejtimin e duhur të shërbimit profesional dhe administrativ.

¹⁰ Ligji nr. 06/L–113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684>

Objektivi specifik 2.4. Rritja e zhvillimit profesional duke zbatuar programe trajnimi për shërbimin profesional dhe stafin menaxherial për t'i përmbushur nevojat në zhvillim të Odës dhe anëtarëve të saj.

Oda, gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të ketë një qasje gjithëpërfshirëse dhe me shikim përpara për t'i forcuar më tej kapacitetet e këtij shërbimi. Një aspekt i rëndësishëm në lidhje me shërbimin profesional është se kapacitetet e tyre të zgjeruara do të forcojnë kontributin e tyre të mëtejshëm për Odën përmes përfshirjes së tyre në proceset dhe aktivitetet e organizuara nga Oda, veçanërisht në politikëbërjen dhe hartimin e akteve ligjore të Odës. Për më tepër, kapaciteti i tyre profesional mund të rrisë kontributin e tyre në aktivitetet e jashtme, si p.sh. pjesëmarrja në grupe pune ose iniciativa të tjera të udhëhequra nga Ministria e Shëndetësisë ose ministritë e tjera për çështje që lidhen me përgjegjësitë e Odës, si dhe për ruajtjen e kujtesës institucionale.

Si rezultat, si hap i parë është kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim i cili do të identifikonte nevojat e stafit profesional për zhvillim të mëtejshëm. Ky aktivitet do të pasohet nga një program trajnimi afatmesëm për t'i adresuar nevojat e tyre. Fushat ku stafi administrativ dhe profesional mund të kërkojë zhvillim të mëtejshëm të njohurive, aftësive dhe kompetencave përfshijnë, por nuk kufizohen në: zbatimin e legjisllacionit për procedurat administrative, në veçanti Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, çështjet që lidhen me procedimin e çështjeve që lidhen me masat disiplinore dhe shkeljet e Kodit të Etikës, hartimin ligjor dhe zhvillimin e politikave, menaxhimin financiar, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin, komunikimin dhe avokimin. Aktivitetet trajnuese në fusha të ngjashme kryhen nga Instituti Kosovar për Administratë Publike si dhe Akademia e Drejtësisë në baza të rregullta. Kështu synohet të bëhen përpjekje për bashkëpunim dhe mundësisht arritjen e memorandumeve të mirëkuptimit me Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Akademinë e Drejtësisë, të cilat do t'ua mundësonin shërbimit profesional të Odës të marrë pjesë në trajnimet e organizuara prej tyre dhe të shqyrtojë mundësinë e bashkëpunimit me institucionet të tjera dhe donatorë.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim për stafin e Odës.
- Hartimi i një programi afatmesëm për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Odës.
- Nënshkrimi i një memorandumi mirëkuptimi për bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, duke ia mundësuar stafit të Odës të marrë pjesë në trajnimet e tyre të organizuara.
- Trajnimi i stafit të shërbimit administrativ, profesional dhe menaxherial
- Krijimi i një "grupi ekspertësh" për të ofruar ekspertizë në aspekte të ndryshme të punës së Odës.

8.3. Licencimi, rilicencimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Objektivi strategjik 3. Avancimi i proceseve të licencimit dhe rilicencimit për të siguruar që anëtarët janë të licencuar dhe përmbushin standardet më të larta të kompetencës dhe etikës, duke siguruar gjithashtu zbatimin cilësor dhe efektiv të programeve të edukimit të vazhdueshëm për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë

Objektivi specifik 3.1. Forcimi i koordinimit ndërmjet Odës dhe institucioneve të tjera përkatëse për të siguruar zbatimin e legjislacionit për licencim dhe rilicencim dhe krijimin e një mekanizmi që adreson harmonizimin e profileve shëndetësore.

Objektivi specifik 3.2. Sigurimi i zhvillimit cilësor të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës bazuar në nevojat e tyre afatmesme.

Objektivi specifik 3.3. Sigurimi i monitorimit cilësor dhe efektiv dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës.

Arritja e këtyre objektivave do të matet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

4. Përqindja e profesionistëve shëndetësorë që janë të licencuar në krahasim me numrin e atyre që janë anëtarë të Odës.
5. Shkalla e mbulimit të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional sipas nevojave të të gjitha profileve profesionale të kujdesit shëndetësor.
6. Numri i kërkesave për anëtarësim dhe licencim në Odë që refuzohen për shkak se profilet e tyre nuk janë në listën zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

Objektivi specifik 3.1. Forcimi i koordinimit ndërmjet Odës dhe institucioneve të tjera përkatëse për të siguruar zbatimin e legjislacionit për licencim dhe rilicencim dhe krijimin e një mekanizmi që adreson harmonizimin e profileve shëndetësore.

Forcimi dhe përmirësimi i procesit të anëtarësimit dhe licencimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor kërkon një angazhim shumëdimensional, duke përfshirë forcimin e koordinimit me institucione të tjera, si Ministria e Shëndetësisë, MASHTI, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, ofruesit e shërbimeve arsimore, etj. Disa nga sfidat që Oda synon t'i adresojë gjatë periudhës afatmesme të mbuluar nga kjo Strategji janë si më poshtë:

- Gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, Oda synon të angazhohet në ruajtjen e mëtejshme të listave dhe gjenerimin e shifrave të sakta për anëtarët e saj dhe listat e anëtarëve të licencuar. Është gjithashtu e rëndësishme të bëhet dallimi i qartë midis atyre që kanë vetëm anëtarësim dhe atyre që kanë edhe licenca. Gjithashtu, qartësimi i statistikave të anëtarëve të punësuar ka një rëndësi të madhe jo vetëm për Odën, por edhe për qëllimet e zhvillimit të politikave në nivel kombëtar. Përveç kësaj, Oda do të punojë në avancimin e komponentëve që gjenerojnë informacionin përmes platformës për anëtarët në bazë të gjinisë, rajonit, profilit dhe vlerave të tjera.
- Forcimi i bashkërendimit të OIK–ut me institucionet e tjera, veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektoratin Shëndetësor, për t'i identifikuar profesionistët e punësuar shëndetësorë të cilëve u ka skaduar licenca ose nuk janë regjistruar fare, veçanërisht në institucionet shëndetësore private.
- Mbështetja e krijimit të një mekanizmi që përfshin MASHTI–n, Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Ministrinë e Shëndetësisë dhe odat profesionale të shëndetësisë për t'i adresuar çështjet që kanë të bëjnë me harmonizimin e profileve që njihen përmes nostrifikimit, por nuk kanë profile të përputhshme në ligjin e shëndetësisë së Kosovës, për t'i parandaluar refuzimet e panevojshme të aplikimeve për

licencim dhe njohjen dhe ekuivalencën e profileve të marra jashtë vendit dhe profileve të akredituara nga agjenci të jashtme që nuk janë të njohura nga Ministria e Shëndetësisë.

- Forcimi i mbikëqyrjes së cilësisë së procesit të licencimit dhe rilicencimit për shkak të volumit të madh të aplikimeve të përpunuara çdo vit.
- Futja e stimuljeve për paguesit e rregullt dhe në kohë, ose ata që paguajnë paraprakisht në fillim për të gjithë periudhën e licencimit mund të jetë e dobishme.

Objektivi specifik 3.2. Sigurimi i zhvillimit cilësor të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës bazuar në nevojat e tyre afatmesme.

OIK-u luan një rol vendimtar në akreditimin e programeve të zhvillimit të vazhdueshëm të ofruara nga operatorë të ndryshëm dhe për të siguruar që profesionistët e kujdesit shëndetësor të grumbullojnë pikët e nevojshme kreditore për rilicencim. Për të siguruar zhvillimin cilësor të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës bazuar në nevojat e tyre afatmesme, Oda do të angazhohet në çështjet e mëposhtme:

- Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse dhe të rregullta të nevojave për trajnim për programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për të siguruar që janë identifikuar nevojat për zhvillim profesional të të gjitha profileve.
- Shfrytëzimi i vlerësimit të fundit të nevojave për trajnim të Spitaleve të Përgjithshme të Republikës së Kosovës, të realizuar nga projekti IHS në vitin 2023, në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të zhvillimit profesional për infermierët në institucionet e përfshira në vlerësim.
- Kalimi nga një plan trajnimi vjetor në një program gjithëpërfshirës shumëvjeçar (p.sh. një program trevjeçar) që trajton në mënyrë më efektive nevojat e zhvillimit profesional të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe rrit akreditimin strategjik të programeve.

Objektivi specifik 3.3. Sigurimi i monitorimit cilësor dhe efektiv dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës.

Një segment tjetër i rëndësishëm në fushën e EVP-së është monitorimi i cilësisë së trajnimit dhe aktiviteteve të tjera të edukimit profesional. Oda tashmë ka angazhuar 22 anëtarë të saj, të cilët janë të ngarkuar me monitorimin e aktiviteteve të EVP-së që janë duke u zhvilluar, dhe brenda 48 orëve ata përgatitin dhe dorëzojnë raportin në KEVP. Cilësia e aktiviteteve vlerësohet edhe nga nëpunësi monitorues (neni 17 i rregullores) nëpërmjet një formulari që i bashkëlidhet rregullores. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e madh të aktiviteteve të EVP-së që po kryhen, monitorimi i zbatimit të tyre dhe veçanërisht i cilësisë së tyre është një sfida për Odën. Prandaj, krahas sigurimit të aktiviteteve për zhvillim profesional sipas nevojave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, Oda synon të forcojë mekanizmin e monitorimit të cilësisë së zbatimit të programeve të akredituara, veçanërisht përmes një sistemi të planifikimit monitorues, ku është i nevojshëm një plan qendror monitorues, i ndjekur nga planet për secilin koordinator monitorimi. Për më tepër, duhet të forcohet koordinimi i monitorimit në nivel qendror në kuadër të Odës dhe të rritet bashkëpunimi me koordinatoret e caktuar për zhvillim profesional në qendrat shëndetësore rajonale.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Zhvillimi i planeve monitoruese për zbatimin e edukimit të vazhdueshëm profesional në çdo qark.
- Raportim i rregullt për monitorimin e aktiviteteve.

8.4. Digjitalizimi

Objektivi strategjik 4. Avancimi i platformës digjitale për të përmirësuar komunikimin, ofrimin e shërbimeve, proceset e brendshme, angazhimin në politikëbërje dhe aftësitë e zhvillimit profesional të Odës, duke siguruar ndërveprim efikas me anëtarët, palët e interesit dhe sistemet kombëtare.

Objektivi specifik 4.1: Përmirësimi i faqes së internetit të Odës, pasurimi i saj me burime shtesë dhe integrimi i platformës me platformat tjera relevante kombëtare dhe të Odës (si e-Kosova, platforma e Administratës Tatimore) për avancimin e proceseve të brendshme dhe qasjen në informacion.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe informatave kthyesë (feedback) në faqen e internetit të Odës, si p.sh. anketat elektronike dhe sistemi i parashtrimit të ankesave, duke mundësuar ndërveprim në kohë reale, mbledhjen e komenteve dhe mbikëqyrjen etike për të angazhuar më mirë anëtarët dhe palët e interesit.

Objektivi specifik 4.3: Sigurimi i më shumë materialeve edukative digjitale dhe ofrimi i mbështetjes për anëtarët për përdorim efektiv të platformës digjitale, duke siguruar edukim profesional gjithëpërfshirës dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet elektronike.

Arritja e këtyre objektivave do të matet nëpërmjet treguesve të mëposhtëm:

4. Numri i përdoruesve që vizitojnë faqen e internetit brenda një periudhe të caktuar.
5. Niveli i kënaqshmërisë së përdoruesve të faqes së internetit të Odës.

Objektivi specifik 4.1: Përmirësimi i faqes së internetit të Odës, pasurimi i saj me burime shtesë dhe integrimi i platformës me platformat tjera relevante kombëtare dhe të Odës (si e-Kosova, platforma e Administratës Tatimore), për avancimin e proceseve të brendshme dhe qasjen në informacion.

Oda tashmë ka një platformë elektronike të avancuar përmes së cilës ofrohen shërbime për anëtarët e saj. Ndër shërbimet që anëtarët mund të kryejnë përmes platformës digjitale janë: procedura e aplikimit për anëtarësim dhe procedurat e licencimit, rilicencimit dhe akreditimit të programeve për edukim të vazhdueshëm. Të gjitha këto shërbime mund të merren plotësisht në mënyrë elektronike përmes platformës digjitale për menaxhimin e profesionistëve shëndetësorë¹¹. Për më tepër, Oda përdor faqen e saj zyrtare¹² (si dhe rrjetet sociale, si Facebook¹³) përmes së cilës ofrohet qasje në informacione rreth aktiviteteve, dokumenteve dhe shërbimeve të tjera të saj. Por, eksplorimi i mundësive të mëtejshme për avancimin e reformave dhe ndjekjen e trendeve të reja të teknologjisë është i nevojshëm. Avancimi i faqes së internetit të OIK–ut dhe faqeve të internetit për odat e tjera për profesionistët e shëndetësisë është ndërmarrë nga Lux Development, përmes një nisme më të gjerë për digjitalizimin e sektorit të kujdesit shëndetësor. Prandaj, Oda do të bashkëpunojë me projektin e Lux Development për të avancuar më tej faqen e internetit të Odës, duke përfshirë platformën e saj elektronike. Gjithashtu, për të lehtësuar qasjen në informacionin e mbajtur nga platforma elektronike kombëtare, si dhe për të garantuar saktësinë e informacionit, Oda do të bëjë përpjekje për të siguruar ndërveprimin e platformës së saj me platforma të tjera zyrtare kombëtare si Regjistri i Gjendjes Civile, platforma e-Kosova, dhe platforma tjera ku regjistrohet stafi profesional mjekësor, si platformat e punësimit, administrata tatimore dhe të ngjashme.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i platformës, siç theksohet në kapitullin që lidhet me licencimin, është përmirësimi i aftësisë së platformës për të gjeneruar informacione dhe statistika kyçe për qëllime raportimi dhe

¹¹ Shih platformën në dispozicion në: <https://oik-ks.org/licencimi/licencimi-me-shkollim-te-mesem-larte/>

¹² Shih faqen e internetit të OIK–ut: <https://oik-ks.org>

¹³ Faqja në Facebook e Odës: <https://www.facebook.com/OdaInfermiereKosoves>

vendimmarrjeje të Odës. Avancimi i këtyre komponentëve do të mbështesë më mirë nevojat e përditshme menaxheriale të Odës dhe do të përmirësojë menaxhimin e përgjithshëm të të dhënave.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Modernizimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të Odës duke e pasuruar atë me komponentë dhe funksionalitete shtesë.
- Eksplorimi i mundësisë së integritit të platformës së Odës me platforma të tjera, si e-Kosova, Regjistri Civil, Regjistri i Punësimit, Administrata Tatimore etj.
- Krijimi i një qendre të brendshme për ruajtjen e të dhënave dhe një arkiv digjital.

Objektivi specifik 4.2: Forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe informatave kthyes (feedback) në faqen e internetit të Odës, si p.sh. anketat elektronike dhe sistemi i parashtrimit të ankesave, duke mundësuar ndërveprim në kohë reale, mbledhjen e komenteve dhe mbikëqyrjen etike për të angazhuar më mirë anëtarët dhe palët e interesit.

Mjetet digjitale ofrojnë mundësi të pafundme për komunikim me anëtarët dhe publikun, si dhe për ofrimin e shërbimeve në mënyrë elektronike. Kështu, avancimi i faqes së internetit të Odës me komponentë dhe module të reja, përmes të cilave anëtarët dhe qytetarët mund të ndërveprojnë, është një nga objektivat për periudhën e ardhshme afatmesme. Oda mund të zgjerojë mjetet e saj digjitale, veçanërisht për të siguruar dy mënyra konsultimi gjatë procesit të hartimit të politikave dhe legjislacionit, duke krijuar kanale komunikimi të drejtpërdrejta, duke zbatuar mjete për anketat me anëtarët dhe perceptimet e publikut dhe kënaqshmërinë me profesionistët shëndetësorë dhe punën e Odës, mjetet për paraqitjen e ankesave në mënyrë elektronike dhe kanalet ku mund të sinjalizohen shkeljet e Kodit të Etikës nga anëtarët e Odës, si dhe mjete elektronike për edukimin përmes platformës dhe sigurimit të materialeve të ndryshme edukative dhe mësimore etj.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Zhvillimi i mekanizmave të reagimit brenda faqes së internetit të Odës për t'i lehtësuar anketat.
- Krijimi i një seksioni për ankesa ose kërkesa në faqen e internetit.
- Zgjerimi i komponentëve të platformës për të gjeneruar statistika dhe raporte për anëtarët, profesionistët e licencuar, programet e akreditimit, etj.
- Shtimi i një veçorie në faqen e internetit për të matur kënaqshmërinë e përdoruesve me faqen e internetit të Odës.

Objektivi specifik 4.3: Sigurimi i më shumë materialeve edukative digjitale dhe ofrimi i mbështetjes për anëtarët për përdorim efektiv të platformës digjitale, duke siguruar edukim profesional gjithëpërfshirës dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet elektronike.

Mbështetja për edukimin e vazhdueshëm profesional, përveç ndjekjes së programeve të akredituara, anëtarëve mund t'u ofrohet në mënyrë të vazhdueshme edhe përmes shkëmbimit të materialeve edukative, të cilave anëtarët mund t'i qasen sa herë që kanë nevojë, si dhe përmes shkëmbimit të përvojave të tyre nëpërmjet rrjeteve elektronike. Arritja e objektivit do të bëhet nëpërmjet krijimit të një biblioteke elektronike, e cila pritet të jetë pjesë e platformës elektronike, ku do të kenë qasje të gjithë anëtarët e Odës. Përveç materialeve të përdorura gjatë programeve të akredituara të edukimit të vazhdueshëm, biblioteka do të ofrojë qasje edhe në materiale të tjera si video, formularë, punime kërkimore, etj.

Një instrument që mund t'i ndihmojë anëtarët e Odës është platforma për komunikim kolegjal, shkëmbim njohurish dhe diskutim për sfidat profesionale. Kanali i komunikimit mund të organizohet për çdo profil veç e veç ose një kanal i vetëm për të gjitha profilet, sipas gjykimit të duhur nga ekspertët e fushave përkatëse.

Për të mbështetur më tej anëtarët e saj, Oda do të fokusohet në lehtësimin e përdorimit të platformës digjitale dhe mjeteve të tjera elektronike. Kjo mund të arrihet përmes sesioneve të trajnimit, udhëzimeve dhe ndihmës së vazhdueshme duke siguruar që anëtarët të përfitojnë nga shërbimet e platformës. Mund të organizohen webinarë dhe seminare të rregullta për t'i njohur anëtarët me veçoritë e reja, përditësimet dhe praktikatat më të

mira në përdorimin e këtyre mjeteve si për zhvillimin profesional dhe për detyra administrative. Oda mund të zbatojë gjithashtu një shërbim 'Helpdesk' për të adresuar çdo sfidë teknike që mund të hasin anëtarët gjatë përdorimit të platformës digjitale.

Gjithashtu, Oda mund të avokojë për integrimin e digjitalizimit në kurrikulat arsimore të programeve të akredituara që mbulojnë infermierët dhe mamitë dhe profesione të tjera. Duke bashkëpunuar me institucionet arsimore, Oda mund të ndikojë në zhvillimin e kurrikulës, duke e bërë kompetencën digjitale një pjesë thelbësore të kualifikimeve profesionale.

Masat specifike për të adresuar këtë objektiv janë si më poshtë:

- Krijimi i një biblioteke elektronike brenda platformës së Odës.
- Organizimi i webinarëve të rregullta dhe seminarëve të trajnimit me anëtarët për t'i njohur ata me veçoritë e reja, përditësimet dhe praktikatat më të mira në mjetet digjitale.
- Avokimi për integrimin e digjitalizimit në kurrikulat e programeve të akredituara që mbulojnë infermierët, mamitë dhe profesione të tjera.

8.5. Avokimi dhe bashkëpunimi

Objektivi strategjik 5. Avancimi i pozitës së Odës në ndikimin e proceseve legjislativë dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin dhe rëndësinë e infermierëve, mamivë dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor për qytetarët.

Objektivi specifik 5.1: Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve dhe aftësive të anëtarëve të OIK–ut për të avokuar në mënyrë efektive për mbrojtjen e interesave të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe avancimin e rolit dhe pozitës së tyre në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Objektivi specifik 5.2: Dhënia e kontributit në përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore që ndikon në interesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, përmes rritjes së ndikimit në proceset vendimmarrëse dhe të formësimit të politikave.

Objektivi specifik 5.3: Rritja e informimit dhe edukimit të publikut mbi rolin vendimtar të profesionistëve shëndetësorë dhe rëndësinë e tyre në sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Objektivat që kanë të bëjnë me avokimin dhe bashkëpunimin janë përfshirë dhe do të adresohen përmes një strategjie të veçantë specifike për avokimin e Odës. Detajet për këtë fushë janë dhënë brenda asaj strategjie.

9. Sistemi i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit për Strategjinë Institucionale të OIK–ut

Sistemi i monitorimit për Strategjinë Institucionale të OIK–ut 2025–2029 është krijuar për të siguruar që objektivat strategjike janë arritur, aktivitetet janë zbatuar dhe përmirësuar vazhdimisht në mënyrë efektive. Korniza e monitorimit synon të masë progresin, t'i identifikojë sfidat dhe të ofrojë komente në kohë, duke ia mundur Odës të qëndrojë në linjë me misionin, vizionin dhe qëllimet e saj strategjike.

9.1. Objektivat e sistemit

Objektivat kryesore të sistemit të monitorimit dhe raportimit janë:

- Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve strategjike dhe sigurimi se ato janë në përputhje me afatet kohore, rezultatet dhe rezultatet e përcaktuara.
- Promovimi i llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizatës duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë për proceset e monitorimit.
- Sigurimi i të dhënave të besueshme për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në prova, duke lejuar Odën të përshtatë strategjitë dhe aktivitetet sipas nevojës.
- Sigurimi që të gjitha palët e interesit, përfshirë anëtarët e Odës dhe partnerët e jashtëm, të jenë të informuar për progresin përmes raportimit të rregullt.

9.2. Struktura e monitorimit dhe raportimit

Struktura monitoruese dhe raportuese për Strategjinë Institucionale të Odës përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

Objektivat, treguesit e performancës dhe Plani i Zbatimit

- Objektivat strategjike, objektivat specifike dhe rezultatet e dëshiruara të strategjive që po zbatohen.
- Treguesit në nivel objektivash dhe aktiviteteve specifike. Treguesit e rezultateve për objektivat specifike dhe treguesit e rezultateve për secilin aktivitet. Treguesit do të mbështeten nga gjendja aktuale (baseline) dhe synimet (targets) aq sa është e mundshme.
- Plani i Zbatimit do të mbulojë të gjithë periudhën 2025–2029 të Strategjisë. Plani i Zbatimit do të rishikohet pas një vlerësimi gjatë vitit të tretë të zbatimit të tij. Një vlerësim i ndërmjetëm për zbatimin e Strategjisë do të bëhet në vitin e tretë të zbatimit të saj, përpara zhvillimit të planit të rishikuar.

9.3. Rolet dhe përgjegjësitë për monitorimin dhe raportimin

Plani i Zbatimit përfshin përgjegjësinë e çdo organi të Odës për çdo aktivitet në plan.

Koordinimi i raportimit kryhet nga një ekip i krijuar për këtë qëllim. Ekipi përfshin përfaqësues nga secili organ i Odës dhe shqyrton raportet periodike, rekomandon fillimin e rishikimit të planit si dhe rishikimin e Strategjisë.

Shërbimi profesional dhe administrativ i Odës do të shërbejë si sekretariat për ekipin dhe do të ofrojë mbështetje profesionale për mbledhjen e informacionit, hartimin e raporteve të zbatimit, dhënien e rekomandimeve, etj. Një zyrtar nga shërbimi profesional dhe administrativ (mundësisht Sekretari i Përgjithshëm) i cili do të kujdeset për koordinimin, raportimin dhe monitorimin e planit do të caktohet nga Oda.

9.4. Shpeshtësia e raportimit

- Raportet tremujore: OIK–u do të përgatisë raporte tremujore duke paraqitur progresin kundrejt aktiviteteve. Këto raporte do të përfshijnë informacion mbi zbatimin, vonesat, rreziqet dhe rekomandimet.
- Raportet vjetore: Do të bëhet një raport vjetor për të raportuar performancën e përgjithshme në arritjen e objektivave nëpërmjet progresit kundrejt treguesve të performancës. Raporti do të përfshijë gjithashtu informacion mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin raportues.

Një vlerësim i ndërmjetëm për zbatimin e Strategjisë do të bëhet në vitin e tretë të zbatimit të saj, përpara rishikimit të planit ekzistues ri, dhe do të shërbejë si bazë për Planin e rishikuar të Zbatimit.

- Raporti përfundimtar i vlerësimit do të hartohet gjatë vitit të fundit të Strategjisë dhe do të bazohet në kriteret e parashikuara në seksionin vijues.

9. 5. Vlerësimi i Strategjisë

Një vlerësim i ndërmjetëm për zbatimin e Strategjisë do të bëhet në vitin e tretë të zbatimit të saj, përpara zhvillimit të planit të ri, dhe do të shërbejë si bazë për planin e ardhshëm të zbatimit. Objektivi kryesor është vlerësimi dhe nxjerrja e mësimave nga zbatimi aktual (ex post), dhe eksplorimi i opsioneve shtesë të politikave për të siguruar vazhdimësinë e qëndrueshme të procesit (ex ante).

Pas përfundimit të Strategjisë, kryhet një vlerësim ex post për të vlerësuar efektivitetin e përgjithshëm, efikasitetin, rëndësinë dhe ndikimin e zbatimit të saj. Ky vlerësim shërben për të analizuar nëse janë arritur objektivat strategjike, si janë përdorur burimet dhe çfarë rezultatesh janë arritur.

Plani i Zbatimit të Strategjisë së OIK-ut 2025-2029

1. Korniza legjislative e OIK-ut

Objektivi strategjik 1. Kornizë legjislative e avancuar dhe gjithëpërfshirëse për OIK-un, duke siguruar që zhvillimi legjislativ të bazohet në analiza, vendimmarrje të bazuar në politika dhe konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit për t'i përmbushur nevojat e Odës dhe anëtarëve të saj.						
1.1.	Objektivi specifik	Treguesi		Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 1.1. Rishikimi, plotësimi dhe harmonizimi i akteve nënligjore me Statutin dhe kornizën tjetër përkatëse ligjore, duke thjeshtuar dhe kodifikuar dispozitat përkatëse për të reduktuar kompleksitetin, për t'i minimizuar mospërputhjet dhe për të rritur qartësinë dhe lehtësuar qasjen.		Përqindja e akteve të Odes që janë harmonizuar me Statutin dhe kornizën ligjore përkatëse			100%	100%
		Rregulloret/aktet nënligjore publikohen 7 dite pas miratimit			Të gjitha aktet janë të publikuara	Të gjitha aktet janë të publikuara
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti
1.	Hartimi i planit legjislativ për Odën	Zyra Ligjore	Në baza vjetore			Plani legjislativ për OIK-un
2.	Rishikimi dhe miratimi i Kodit të Etikës	Zyra Ligjore	TM1 2025			Kodi i Etikës është miratuar
3.	Rishikimi dhe miratimi i Rregullores për Prokurorin e Odës	Zyra Ligjore	TM1 2025			Rregullorja për Prokurorin e Odës është miratuar
4.	Rishikimi dhe miratimi i Rregullores për Gjykatën e Nderit	Zyra Ligjore	TM1 2025			Rregullorja për Gjykatën e Nderit është miratuar
5.	Bashkëpunimi me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore për përcaktimin e listës së shërbimeve dhe çmimoreve të shërbimeve infermiere dhe shërbimeve të tjera përkatëse të profesionistëve tjerë shëndetësorë	Kryetarja e OIK-ut	TM1 2026			Lista e shërbimeve dhe çmimorja e shërbimeve infermiere dhe shërbimeve të tjera përkatëse të profesionistëve tjerë shëndetësorë Kërkohet amendamenti i Udhëzimit Administrativ nr. 03/2024 - Bashkëpagesat për Shërbimet Shëndetësore

6.	Identifikimi dhe rishikimi udhëzuesve dhe procedurave standarde operative për zbatimin e legjislacionit të Odës	Zyra Ligjore	TM2 2025			Lista e udhëzuesve dhe procedurave standarde operative	
7.	Hartimi i udhëzuesve dhe procedurave standarde operative	Zyra Ligjore	TM2 2026			Udhëzuesit e identifikuar të hartuar	
1.2.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi i politikave si bazë për të gjitha proceset e hartimit dhe rishikimit legjislativ.		Numri i dokumenteve të politikave të hartuara për të shërbyer si bazë për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit.				20% e akteve të miratuara	30% e akteve të miratuara
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Hartimi i udhëzuesit dhe procedurave për zhvillimin dhe analizën e politikave në Odë	Zyra Ligjor, KD	TM1 2026?			Udhëzuesi dhe procedurat për hartimin e politikave në Odë	
2.	Zhvillimi i analizës para hartimit të akteve të Odës	Grupi për hartimin e aktit përkatës	Në vazhdimësi			Dokumente e politikave të finalizuara nga Oda	
3.	Trajnimi i stafit të Odës për të kryer analiza të politikave	Shërbimi profesional	Në vazhdimësi			Stafi i trajnuar	
4.	Takime të rregullta me profesionistët shëndetësorë (fusha që përfaqëson OIK-u) për identifikimin e nevojave për zhvillim të Odës	KD	Në vazhdimësi			Së paku një takim në vit	

1.3	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
1.3	Objektivi specifik 1.3. Avancimi i përfshirjes dhe konsultimit të palëve të interesit në hartimin e legjislacionit të OIK-ut.	Numri i palëve të interesit të përfshira në mënyrë aktive në procesin e konsultimit për çdo akt legjislativ të konsultuar.				Synimi vendoset pasi të vendoset 'gjendja aktuale'	Synimi vendoset pasi të vendoset 'gjendja aktuale'
		Përqindja e dokumenteve të konsultuara për të cilat publikohen raportet e konsultimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të procesit të konsultimit.			0	100%	100%
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Hartimi i udhëzuesit për procesin e konsultimit publik të legjislacionit të hartuar nga Oda	Shërbimi profesional, KD	TM1 2026			Udhëzuesi për procesin e konsultimit publik të legjislacionit të hartuar nga Oda është finalizuar	
2.	Organizimi i ngjarjeve për t'u konsultuar me palët e interesit për secilën rregullore	KD	Në vazhdimësi			X ngjarje për secilin akt	
3.	Publikimi i projekt rregulloreve dhe akteve të tjera për konsultim në platformë	KD, Kryesuesi i grupit	Në vazhdimësi			Rregulloret e publikuara në faqen e internetit dhe koha e hapur për konsultim së paku 15 ditë	
4.	Publikimi i raporteve të konsultimit për çdo rregullore të konsultuar	KD, Kryesuesi i grupit	15 ditë pas mbylljes së procesit të konsultimit			Raportet e konsultimit për çdo projekt akt të publikuar 1 muaj pas mbylljes së afatit për konsultim	
5.	Përfshirja e ekspertëve dhe palëve të interesit në fazën fillestare të hartimit të akteve	KD, Kryesuesi i grupit	Për secilin akt që hartohet			Ekspertë dhe palë të interesit përfshihen në grupin punues për hartimin e aktit përkatës	

1.4.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
	Objektivi specifik 1.4. Avancimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e legjislacionit të Odës dhe përmirësimi i mjeteve për informimin, drejtimin dhe lehtësimin e zbatimit të legjislacionit për organet e Odës dhe anëtarët e saj.	Numri i raporteve të monitorimit të hartuara çdo vit për zbatimin e akteve legjislative			0	1	1
		Numri i aktiviteteve promovuese, informuese dhe udhëzuese të organizuara pas miratimit të legjislacionit					
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
2.	Zhvillimi i aktiviteteve me anëtarët e Odës pas miratimit të çdo rregulloreje për të informuar, udhëzuar dhe lehtësuar zbatimin e legjislacionit	KD, Zyra Ligjore	Pas miratimit të çdo akti			Xy aktivitete për çdo akt të miratuar	
3.	Zhvillimi i vlerësimit për zbatimin e akteve të caktuara të Odës	KD	TM4 2027 TM4 2029			2 vlerësime janë realizuar	
4.	Trajnimi i stafit të Odës për monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit	Shërbimi profesional	Në vazhdimësi			Stafi i trajnuar	
5.	Publikimi i materialeve udhëzuese më të fundit, përfshirë materialet ndihmëse, videot etj., për zbatim të legjislacionit	Organet e OIK-ut, Stafi profesional	Në vazhdimësi				
6.	Hartimi i dokumentit “Karta e Infermierisë”	OIK-u në bashkëpunim me MSH-në	2025-2026			Dokumenti “Karta e Infermierisë” e hartuar nga ana e Odës	
7.	Hartimi i dokumentit “Karta e Mamisë”	OIK-u në bashkëpunim me MSH-në	2025-2026			Dokumenti “Karta e Mamisë” e hartuar nga ana e Odës	

2. Qeverisja dhe shërbimi profesional

Objektivi strategjik 2. Sigurimi i qeverisjes efektive, efikase, transparente dhe llogaridhënese dhe shërbimi profesional administrativ i Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë							
2.1.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 2.1. Avancimi i sistemit të planifikimit afatmesëm të Odës, duke përfshirë planifikimin afatmesëm të punës, atë financiar dhe buxhetor, për t'i harmonizuar më mirë burimet me prioritetet strategjike.		Miratimi i Kornizës Afatmesme të Planifikimit Buxhetor			0	0	Plani buxhetor afatmesëm është miratuar
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Miratimi i udhëzuesit për procesin e zhvillimit dhe formatit të dokumenteve të planifikimit afatmesëm	Zyra e Financave	2028			Udhëzuesi është hartuar dhe miratuar	
2.	Hartimi i dokumentit të planifikimit buxhetor afatmesëm	Zyra e Financave	2028			Hartimi dhe miratimi i dokumentit të planifikimit buxhetor afatmesëm	
3.	Hartimi i raportit periodik të shpenzimeve të Odës	Zyra e Financave	Në vazhdimësi			Raportet periodike janë prodhuar	
4.	Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të rregullta për stafin profesional në menaxhimin e financave dhe projekteve	Shërbimi profesional	Në vazhdimësi			Stafi i trajnuar	

2.2.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
	Objektivi specifik 2.2. Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar që dokumentet kyçe si aktet legislative, planet e punës, planet financiare dhe raportet e auditimit të jenë lehtësisht të qasshme në faqen e internetit të OIK-ut, duke aplikuar gjithashtu rregullisht mekanizma për të marrë komente kthyes (feedback) nga anëtarët dhe palët e tjera të interesit që përfitojnë nga shërbimet e profesionistëve shëndetësorë.	Të gjitha aktet nënligjore, planet dhe raportet si dhe informacionet tjera publikohen në faqen e internetit të institucionit.				Të gjitha publikohen brenda një jave pas miratimit	Të gjitha publikohen brenda një jave pas miratimit
		Niveli i kënaqshmërisë së anëtarëve me punën e Odës				Synimi të vendoset pas anketës së parë	Synimi të vendoset pas anketës së parë
		Niveli i kënaqshmërisë së pacientëve me punën e anëtarëve të Odës				Synimi të vendoset pas anketës së parë	Synimi të vendoset pas anketës së parë
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Publikimi i të gjitha dokumenteve legislative, planeve dhe dokumenteve tjera në faqen e internetit të Odës	Zyra e Komunikimit	Në vazhdimësi			Të gjitha dokumentet e publikuara	
2.	Përcaktimi i kriterëve të qarta për themelimin e Komisioneve të Odës	KD, Shërbimi profesional	TM2 2025				
3.	Hartimi i udhëzuesit për zhvillimin e anketave	KD, Shërbimi profesional	TM2 2025			Udhëzimet e hartuara dhe të miratuara	
4.	Zhvillimi i anketës së opinionit të kënaqshmërisë së anëtarëve me punën e Odës	Shërbimi profesional, KD	Çdo dy vite, duke filluar nga 2025			Anketat zhvillohen çdo dy vite	
5.	Zhvillimi i anketës së opinionit të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e anëtarëve të Odës	Shërbimi profesional, KD	Çdo dy vite, duke filluar nga 2025			Anketat zhvillohen çdo dy vite	

6.	Krijimi i një mekanizmi online për marrjen në vazhdimësi të opinionit të anëtarëve dhe palëve të interesit për punën e Odës	IT, Shërbimi profesional	TM1 2025			Mekanizmi i vendosur në faqen e internetit të Odës	
7.	Planifikimi i mbikëqyrjes vjetore për punën e Odës	KD	Çdo vit			Plani vjetor i mbikëqyrjes	
8.	Hartimi i raporteve vjetore të mbikëqyrjes së brendshme	KD	TM4 2025			Raporti vjetor i mbikëqyrjes	
2.3	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 2.3. Avancimi i strukturës së brendshme dhe proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e Odës.		Organizimi i brendshëm i OIK-ut në përputhje me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës					Plotësisht në përputhje me Rregulloren
		Përqindja e stafit që merr vlerësime vjetore të performancës				100%	100%
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Rishikimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës së Odës	Zyra Ligjore	TM2 2026			Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës së Odës është miratuar	
2.	Organizimi i shërbimit profesional dhe administrativ të Odës sipas rregullores së rishikuar	Zyra Ligjore	TM4 2026			Është përfunduar organizimi në bazë të rregullores	
2.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 2.4. Rritja e zhvillimit profesional duke zbatuar programe trajnimi për shërbimin profesional dhe stafin menaxherial për t'i përmbushur nevojat në zhvillim të Odës dhe anëtarëve të saj.		Zhvillimi i një plani shumëvjeçar të zhvillimit profesional në përputhje me vlerësimin e zhvillimit të kapaciteteve të Odës				Është kryer	Është kryer
		Përqindja e personelit që merr pjesë të paktën një herë në programet e trajnimit				50%	100%

Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti
1.	Kryerja e vlerësimeve të nevojave për trajnim për stafin e Odës	Njësia e Burimeve Njerëzore	TM4 2025			Është zhvilluar vlerësimi i nevojave për trajnim
2.	Hartimi i programit afatmesëm për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Odës	Njësia e Burimeve Njerëzore	TM1 2026			Programi afatmesëm për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Odës
3.	Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombetare i cili do t'ia mundësonte stafit të OIK-ut të marrë pjesë në trajnimet e organizuara prej tyre	Kryetarja, KD	2025-2026			Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar Një numër i stafit ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga IKAP
4.	Trajnimi i stafit administrativ të shërbimit profesional dhe menaxherial	Njësia e Burimeve Njerëzore koordinohet me institucionet që mundësojnë organizimin dhe pjesëmarrjen	2025			Stafi i shërbimit profesional dhe menaxherial i trajnuar
5.	Krijimi i një “grup ekspertësh” të cilët do të angazhohen në ofrimin e ekspertizës në aspekte të ndryshme të Odës	KD	TM4 2025			Lista e grupit të ekspertëve përmes shprehjes së interesit nga një proces i hapur konkurrues

3. Licencimi, rilicencimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Objektivi strategjik 3. Avancimi i proceseve të licencimit dhe rilicencimit për të siguruar që anëtarët janë licencuar dhe përmbushin standardet më të larta të kompetencës dhe etikës, duke siguruar gjithashtu zbatimin cilësor dhe efektiv të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë shëndetësorë							
1.1.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 3.1. Forcimi i koordinimit ndërmjet Odës dhe institucioneve të tjera përkatëse për të siguruar zbatimin e legjislacionit për licencim dhe rilicencim si dhe krijimin e një mekanizmi që adreson harmonizimin e profileve shëndetësore.		Përqindja e profesionistëve shëndetësorë që janë të licencuar në krahasim me numrin e atyre që janë anëtarë të Odës					Objektivi do të vendoset pasi të identifikohet numri i të licencuarve që nuk përmbushin detyrimet
		Numri i kërkesave për anëtarësim dhe licenca në Odë që refuzohen për shkak se profilet e tyre nuk janë në listën zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë					
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1	Avokimi i krijimit të një mekanizmi koordinues në mes të OIK-ut, MSH-së dhe AKA-së për t'i harmonizuar profilet profesionale shëndetësore	Kryetarja, KD	Në vazhdimësi			Mekanizmi i bashkëpunimit funksional	
2	Zgjerimi i bashkëpunimit me Inspektoratin Shëndetësor për të siguruar që të gjithë profesionistët shëndetësorë që janë duke punuar janë të licencuar	Kryetarja, KD	Në vazhdimësi				

3	Avancimi i shërbimit në mirëmbajtjen e listës së anëtarëve dhe të licencuarve sipas profileve për të siguruar statistika të sakta mbi numrin e anëtarëve dhe të licencuarve	Zyra e Licencimit, Zyra e IT	2025			Statistikat për anëtarët e Odës dhe të licencuarit janë të sakta	
4	Avancimi i komponentëve të faqes së internetit të OIK-ut që gjenerojnë të dhëna sipas profileve të profesionistëve, gjinisë, rajonit, moshës, nivelit të shkollimit etj.	IT	2025			Komponentët në faqen e internetit të Odës janë avancuar	
2.2.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 3.2. Sigurimi i zhvillimit cilësor të programeve të edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës bazuar në nevojat e tyre afatmesme.		Shkalla e mbulueshmërisë me programe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional sipas nevojave të të gjitha profileve të profesionistëve shëndetësorë.					50%
							50%
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse dhe të rregullta të nevojave për trajnime për programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional bazuar në rregulloren e OIK-ut	Zyra për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, në bashkëpunim me komisionet përkatëse	TM3, çdo vit			Vlerësimet e nevojave për trajnim zhvillohen Qarkore informative shpërndahen tek të gjitha institucionet shëndetësore	

2.	Hartimi programeve për edukimin e vazhdueshëm bazuar në nevojat specifike të profileve të anëtarëve të OIK-ut	Zyra për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, në bashkëpunim me komisionet përkatëse	TM4, rishikohet çdo vit			Programi i zhvillimit profesional trevjeçar është hartuar	
3.	Hartimi i raporteve vjetore për zbatimin e programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional	Zyra për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, në bashkëpunim me komisionet përkatëse	TM4, çdo vit			Raporti vjetor për zbatimin e programit të zhvillimit profesional do të përfundohet deri në fund të marsit të vitit pasues	
3.3.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 3.3. Sigurimi i monitorimit cilësor dhe efektiv dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional për të gjitha profilet e Odës.		Përqindja e raporteve të monitorimit të dorëzuara brenda 48 orëve nga përfundimi i aktivitetit të EVP-së dhe përmbushja e kërkesave të parapara në rregullore.				100%	100%
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Hartimi i planeve të monitorimit të zbatimit të edukimit të vazhdueshëm profesional për secilin rajon	Zyra për Edukim të Vazhdueshëm	TM1 të vitit aktual			Planet e monitorimit për secilin rajon	
2.	Raportimi i rregullt i monitorimit të aktiviteteve	Zyra për Edukim të Vazhdueshëm	TM4 të vitit aktual			Raporti i rregullt i trajnimeve	

4. Digjitalizimi

Objektivi strategjik 4. Avancimi i platformës digjitale për të përmirësuar komunikimin, ofrimin e shërbimeve, proceset e brendshme, angazhimin në politikëbërje dhe aftësitë e zhvillimit profesional të Odës, duke siguruar ndërveprim efikas me anëtarët, palët e interesit dhe sistemet kombëtare.							
1.1.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 4.1: Përmirësimi i faqes së internetit të Odës, pasurimi i saj me burime shtesë dhe integrimi i platformës me platformat tjera relevante kombëtare dhe të Odës (si e-Kosova, platforma e Administratës Tatimore) për avancimin e proceseve të brendshme dhe qasjen në informacion.		Legjislacioni, dokumentet, raportet etj., janë vënë në dispozicion në faqen e internetit të Odës për anëtarët dhe publikun.				Të gjitha	Të gjitha
		Numri i përdoruesve që vizitojnë faqen e internetit në një periudhë të caktuar.				Synimi caktohet pasi të vendoset ‘gjendja aktuale’	Synimi caktohet pasi të vendoset ‘gjendja aktuale’
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Modernizimi dhe avancimi faqes së internetit të Odës, duke e pasuruar atë me komponentë shtesë	IT, KD	TM3 2025			Faqja e internetit është avancuar. Komponentët mund të shtohen këtu si produkte. Është pjesë e projektit të përbashkët për të gjitha odat.	
2.	Eksplorimi i mundësisë së lidhjes së platformës së OIK-ut me platformat tjera, si: e-Kosova, Regjistri Civil, Regjistri i Punësimit, ATK etj.	IT, KD	TM3 2025			Platformat e OIK-ut të integruara me e-Kosova, Regjistrin Civil me platformat tjera	

3.	Ndërtimi i qendrës së brendshme për ruajtjen e të dhënave dhe arkivit digjital	IT, KD	TM2 2025			Qendra për ruajtjen e të dhënave dhe arkivi digjital, të ndërtuar	
4.	Digjitalizimi i të gjitha proceseve të arkivit	IT	TM3 2025			Proceset e arkivit, të digjitalizuara	
2.2.	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
Objektivi specifik 4.2: Forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe informatave kthye (feedback) në faqen e internetit të Odës, si p.sh. anketat elektronike dhe sistemi i parashtrimit të ankesave, duke mundësuar ndërveprim në kohë reale, mbledhjen e komenteve dhe mbikëqyrjen etike për të angazhuar më mirë anëtarët dhe palët e interesit.		Shkalla e kënaqshmërisë së përdoruesve të faqes së internetit të Odës.			Vendoset pasi të aktivizohet funksioni në faqen e internetit	Vendoset pasi të aktivizohet funksioni në faqen e internetit	Vendoset pasi të aktivizohet funksioni në faqen e internetit
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Zhvillimi i mekanizmave të komenteve kthye brenda faqes së internetit të Odës për të zhvilluar anketa	IT, KD	TM3 2025			Mekanizmat e komenteve kthye brenda faqes së internetit të Odës për të zhvilluar anketa janë të disponueshëm	
2.	Krijimi i një seksioni për ankesa ose kërkesa në kuadër të faqes së internetit	IT, KD	TM3 2025			Seksioni per ankesa ose kërkesa në kuadër të faqes së internetit i krijuar	
3.	Zgjerimi i komponentëve të platformës që gjenerojnë statistika dhe raporte për anëtarët, profesionistët e licencuar, programet e akreditimit, etj.	IT, KD	TM3 2025			Mund të gjenerohen raporte dhe statistika	
4.	Vendosja e një funksioni në faqen e internetit për matjen e kënaqshmërisë së përdoruesve me faqen e internetit të Odës	IT, KD	TM3 2025			Funksioni për matjen e kënaqshmërisë së përdoruesve me faqen e internetit të Odës, aktiv	

2.3	Objektivi specifik	Treguesi			Gjendja aktuale	Synimi 2027	Synimi 2029
	Objektivi specifik 4.3: Sigurimi i më shumë materialeve edukative digjitale dhe ofrimi i mbështetjes për anëtarët për përdorim efektiv të platformës digjitale, duke siguruar edukim profesional gjithëpërfshirës dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet elektronike	Programet e edukimit janë të disponueshme në bibliotekën elektronike si pjesë e akredituar/dorëzuar? programet e edukimit të vazhdueshëm profesional					
		Numri i anëtarëve të OIK-ut të trajnuar për digjitalizimin dhe përdorimin e platformave online.					
Nr.	Aktiviteti	Organi/Njësia Përgjegjëse	Afati i fundit	Kostoja	Burimi i buxhetit	Produkti	
1.	Krijimi i bibliotekës elektronike brenda platformës së OIK-ut	IT, KD	TM3 2025			Biblioteka elektronike brenda platformës së OIK-ut është e disponueshme Materialet e publikuara	
2.	Organizimi i webinarëve dhe seminarëve të rregullta të aktiviteteve të trajnimit me anëtarët për t'i njohur ata me veçoritë e reja, përditësimet dhe praktikat më të mira të mjeteve digjitale	KD, Shërbimi profesional	Në vazhdimësi			Numri i trajnimeve të organizuara brenda vitit	
3.	Avokimi për integrimin e digjitalizimit në kurrikulat edukative të programeve të akredituara që mbulojnë infermierët dhe mamitë dhe profesionet tjera	KD, Shërbimi profesional	Në vazhdimësi			Numri i aktiviteteve avokuese të organizuara brenda vitit	

